

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 189, Korrik 2019

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## VJOLLCA E DUKAGJINIT

Jam rrite tue e adhurie si lule, mbimja e saj ka kenë një nga dhuratat e natyrës malsore, sa shendin e binte kjo lule mbas dimnave të gjatë e të randë. Nuk kishte ma knaqsi se me e pa ngjyrën e çiltë të saj, kur petalet i qeshnin në shpërthim mbi tokën ku sapo ish dejë bora (shkri bora). E qeshun lulje si me kenë qeshje njeri të lumtun, patravajë. Shpesh ma kujtojnë qeshjen e kesaj lulje do ftyra njerezish këtu në Amerikë ku jetoj, disa njerez që e di se i kanë qitë të tana vendave, e s'kanë farë halli në ftyre të Tokës. Malsorët e kanë njoftë si lule me kohë, njaq sa prej ngjyres së saj ia kanë dhënë edhe emnin njenës nga te shtatë ngjyrat, asaj që në gjuhën e standartizime i thonë "E Verdha" - malsoret i thone "E Lultë /-a". E Lultë si kjo Lule që qeshet me tanë optimizmin e ngjyrës së vet...ka ardhë pranvera...gëzoni. Lulja quhet "Vjollca e Dukagjinit".  
Pse e ka bash këtë emën!?

14



## TREVESAT SHTROHEN ME SHQIPTARË

Në familjen e biznesmenit Ndue Ftoni në 15-vjetorin e datëlindjes së djalit të tij

Ishte nder i veçantë për mua që mora pjesë në një datëlindje aq madhështore me qindra të ftuar dhe mes shumë personalitetesh.

Biznesmeni i suksesshëm shqiptaro-amerikan me origjinë nga Dukagjini, kremtonte datëlindjen e djalit të tij, tanimë 15-vjeçar, Ronaldo Ftoni. Ai kishte zgjedhur ta celebronte këtë festë në Atdhe, në Shkodrën e tij mes miqëve, të afërmëve dhe dashamirëve, mes artistëve të nderuar shkodranë e jo vetëm, duke treguar kështu se festat tona shqiptare ruajnë traditat më të mira të popullit tonë dhe e tillë ishte kjo festë, që për nga pjesëmarrja kishte përmasat e një dasme të madhe.

2



## PROFESOR AHMET OSJA - MJESHTËR I MADH - 80 VITE JETË, PUNË, KRIJIMTARI

Me datën 13 korrik 2019, në mjediset e hotel "ROZAFÄ" u bashkuan miq, dashamirës, të afërt të Profesor Ahmet OSJES.

Një njeri i mirë, një agronom e një specialist i bujqësisë shumë i njohur në të gjithë vendin e më gjerë, një figurë shumë e dashur për këdo që e ka njohur, për këdo me të cilin ka bashkëpunuar, për këdo me të cilin e kanë lidhur rrugët e jetës.

3



## HISTORIA E LUFTËS KUNDËR MALIT TË ZI E VITIT 1915, NJË MUNOMENT I GJALLË KUJTESE

**Prele Milani:** E dija se gjendej në dorëshkrim, u gëzova kur mësova se kishte hyrë në magje. Kishte kohë që prisja me interes të dilte nga "furra" e mora të ngrohtë dhe kapërdiva si urituri simiten me djathë. Ja fillova gjithë etje leximit, nuk ju ndava për një ditë e gjysmë, e putha me buzë kuq dhjetëra herë (nënvizimi me lapustil) dhe udhëtova 105 vite në kohën e shkuar. Historia e Luftës Kundër Malit Të Zi. (Kujtime të vitit 1915 e At Benardin Llutit), është një autorëfim i vetëm dhe krejt veçantë i një regjisorit, aktorit, patriotit, trimi të pa epur, kleriku "mëkatar". Ky burrë inteligjent me zemër të madhe, vjen mrekullisht si rrufepitës e kronikan i krahinës së Nikaj Merturit në një nga ngjarjet më dramatike të fillim shekullit të 20-të.

5





# TREVESAT SHTROHEN ME SHQIPTARË

*Në familjen e biznesmenit Ndue Ftoni në 15-vjetorin e datëlindjes së djalit të tij*

Ishte nder i veçantë për mua që mora pjesë në një datëlindje aq madhështore me qindra të ftuar dhe mes shumë personalitetesh.

Biznesmeni i suksesshëm shqiptaro-amerikan me origjinë nga Dukagjini, kremtonte datëlindjen e djalit të tij, tanimë 15-vjeçar, Ronaldo Ftoni. Ai kishte zgjedhur ta celebronte këtë festë në Atdhe, në Shkodrën e tij mes miqëve, të afërmëve dhe dashamirëve, mes artistëve të nderuar shkodranë e jo vetëm, duke treguar kështu se festat tona shqiptare ruajnë traditat më të mira të popullit tonë dhe e tillë ishte kjo festë, që për nga pjesëmarrja kishte përmasat e një dasme të madhe.

Unë isha atje dhe e përjetova këtë festë me të gjitha detajet dhe emocionet.

Ndue Ftoni është një malësor nga Dukagjini, i cili ka emigruar në SHBA në vitin 1996 dhe atje në sajë të këmbënguljes, vullnetit dhe aftësive të tija ka korrë sukses, duke u bërë një nga biznesmenët më të nderuar në Diasporën Shqiptare. Ndue Ftoni ka një kontribut të jashtëzakonshëm edhe në zhvillimin, publikimin dhe ruajtjen e vlerave kombëtare kulturore dhe artistike.

Për mua dhe gjithë të pranishmit, pikërisht ardhja e tij familjarisht nga Amerika për të festuar datëlindjen e djalit të tij të vetëm në Shqipëri, mes shqiptarësh është dekorata më e nderuar që mund ta vëmë në gjoksin e tij.

Salla madhështore e Art Center "Blue Sky" u bë trevesa që shtroi për miqtë e zotit të shtëpisë Ndue Ftoni. Çdo gjë: mikëpritja, bujaria, kënga, vallja dhe urimet ishte shqiptare. Dy flamuj madhështorë shqiptar dhe amerikan dekoronin sallën për të treguar lidhjet historike të dy kombeve.

Me ka rastisur të marr pjesë në shumë trevesa e gëzime dhe gjithmonë kam përjetuar emocione të veçanta e që nuk harrohen lehtë sado që ato janë pafund, me familjarë e miq të artit, ekranit e te fushave të ndryshme të jetës, por emocionet e darkës familjare të shtruar nga miku dhe dashamirësi i shqiptarëve Ndue Ftoni do mbetet një trevese e veçantë në kuptimin e vërtetë të fjalës Bujari. Në pamundësi për t'i pasur pranë të gjithë, ka ardhur enkas nga Amerika e Largët bashkë me familjen e tij për ta ndarë me ne gëzimin më të madh të zemrës së vet, datëlindjen e 15 të djalit të vetëm, Ronaldos.

Bujaria dhe dashamirësia e tij janë armët më të forta me të cilat ka luftuar dhe skalitur emrin e vet në mesin e qindra mijërave shqiptarëve të emigruar larg trojeve të veta aq sa Ndue Ftoni është një nga emrat më të njohur në Michigan si

biznesmen dhe figurë e spikatur në mesin e njerëzve me të suksesshëm të atij vendi.

Bujaria e tij rrezatoi dukshëm në gëzimin që ndan me ne në këtë trevese të shtruar për familjar, të afërm, miq e të ftuar të nderuar me statuse të larta në fushën e artit e kulturës shqiptare si prof.

etar i Shoqatës Atdhetare "Malsia", si dhe shumë shaljanë, që Ndue Ftoni ka bashkëjetuar për 10 vite në zonën e Mjedës dhe Gurit të Zi.

Në këtë gëzim familjar nuk munguan asnjë nga ata më të nderuarit e fshatit Shosh, me të cilët Ndue Ftoni është lindur

familje, e cila me të vërtetë është ndër të rrallat me të cilat mund të mburremi e themi se jemi shqiptar.

Ndue Ftoni djali tu baftë plak i urtë e fisnik si baba e hisja e tij tu baftë lagje. Ty ta shtoftë Zoti bujarinë e mirësinë e shpirtit tand e kurrë mos ta mungoftë!

Zoti mirëqenien! Këto ishin disa nga urimet tradicionale që i erdhën këtë mbrëmje nga të ftuarit çiftit Ftoni dhe djaloshit Ronaldo Ftoni, i cili edhe pse ka lindur në SHBA, është bir i vërtetë dhe i denjë tërësisht shqiptar.

Në këtë mbrëmje e morën fjalën shumë nga të ftuarit, por unë do të veçoj tre prej tyre, Prof. Fadil Kraja "Mjeshtër i Madh", autor i librit "Guxo", dedikuar Ndue Ftonit ndër të tjera, duke uruar Ronaldon 15 vjeçar u shpreh: "Kam dëgjuar se njëri nga Presidentët Amerikan Xhorxh Uashington e ka pasur nënën shqiptare, malësore nga Malësia e Madhe. Ti djalosh ke lindur në Amerikë, e pse jo edhe ti, të mos bëhesh një ditë President i Amerikës".

Drejtori i Pergjithshëm Qendra e Artit dhe Kulturës Shqiptare Dr. Minella Kureta "Mjeshtër i Madh" ndër të tjera tha: "Ndue Ftoni është biznesmen suksesi. Humanist dhe mbështetës i paqes sociale. Vepërimtar i shquar i vlerave lirishtetërore kombëtare dhe një sensibilizues e promovues shembullor i tyre. Vjues i denjë i virtuteve tradicionale. Artdashës dhe mbështetës, si dhe sponsorizues nga më të rëndësishmit i vlerave kulturore artistike në Shqipëri dhe në Bashkësinë Shqiptarë të Diasporës".

Me humorin që e karakterizon, aktori i famshëm i Teatrit "Migjeni" Besnik Çinari "Mjeshtër i Madh" iu drejtua të pranishmëve: "Unë kam qenë shumë e shumë herë në Amerikë, ku jam pritur me respekt dhe nderime nga ky burrë që na ka mbledhur sonte. Kam njohur atje me dhjetra biznesmenë, artistë, studiues e të tjerë, e të tjerë, por kam vënë re që shumica e fëmijëve të tyre nuk flasin ose kuptojnë shumë pak gjuhën shqipe dhe këtu bën diferencën miku ynë Ndue Ftoni, i cili nuk është kujdesur vetëm për suksesin në biznes, por për edukimin dhe formimin e fëmijëve të tij si shqiptarë".

Më pas Besa e mbylli me një batutë të urtë dhe me humor: "Por ta dish Ndue Ftoni se një burrë i mirë nuk mund të jetë kurrë i mirë, pa pas një grua të mirë. Ronaldos i uroj nga zemra edhe 100 vite të lumtura e të suksesshme bashkë me familjen e tij të mrekullueshme".

Mbresat e kësaj mbrëmje familjare ishin të mëdha, ishin të paharrueshme edhe do të mbeten në kujtesë për shumë kohë tek të pranishmit, si një shembull i trashëgimit të traditës sonë shqiptare.

**Ramazan Çeka**



Fadil Kraja, dramaturgu i shquar shqiptar, Drejtori i Pergjithshëm Qendra e Artit dhe Kulturës Shqiptare Dr. Minella Kureta «Mjeshtër i Madh», si dhe shumë personalitete të tjera si Kryetari i Shoqatës «Dukagjini» në Shkodër Ndue Sanaj dhe ish Kryetari i Shoqatës «Dukagjini» në Amerikë Nikolin Shyti, Frrok Gjoni ish deputet i PS, Gjon Marku nënkryetar i Qarkut Shkodër, ish piloti i aviacionit dhe punonjës i gardës Ndue Doda, Nikolin Thana themelues i PD në Shkodër, Mark Babani biznesmen i suksesshëm dhe Kryetar i Bashkisë Vau Dejës, Vasel Muça biznesmen, grupi drejtues i TV Kopluku, Paulin Ndoja "Mjeshtër i Merituar i Sportit" ish futbollist i Klubit "Vllaznia", poeti Gjovalin Dushaj, shkrimtari dhe studiuesi Kadri Fikaj, këngëtarët Hajro Pepaj, Gofile Papekaj, Prek Mrishaj, Gjovain Shani e të tjerë. Ilmi Kurti Kry-

dhe rritur me ta.

Nuk e fsheh dot mirënjohjen time ndaj kësaj familje pasi pak ditë më parë unë isha i ftuar në shtëpinë e tij në Amerikë bashkë me disa miq, ku pritja mori kuptimin e një feste familjare.

Ishin disa orë të gëzueshme e të paharrueshme për mua dhe miqtë e mi. Dashamirsi, bujari, këngë e biseda përtej kënaqësive që zakonisht i bashkon shqiptarët në mërgim.

Si duket Ndue Ftoni ruan të fortë lidhjen e tij me truallin nga ka rrënjët, mikpritjen dhe bujarinë, të cilat po ia kultivon edhe familjes së vet atje në Amerikën e Largët, pasi merita të veçanta ka dhe familja e në veçanti gruaja e tij e mrekullueshme znj. File Ftoni, e cila me një dashamirësi e shumë bujari pret e përcjell çdo ditë shqiptarë në shtëpinë e saj.

Mirënjohje e falenderime ndaj kësaj



# PROFESOR AHMET OSJA

## - MJESHTËR I MADH - 80 VITE JETË, PUNË, KRIJIMTARI

Me datën 13 korrik 2019, në mjediset e hotel "ROZAFJA" u bashkuan miq, dashamirës, të afërt të Profesor Ahmet OSJES.

Një njeri i mirë, një agronom e një specialist i bujqësisë shumë i njohur në të gjithë vendin e më gjerë, një figurë shumë e dashur për këdo që e ka njohur, për këdo me të cilin ka bashkëpunuar, për këdo me të cilin e kanë lidhur rrugët e jetës.

Profesor Ahmeti vjen nga një familje patriotike dhe liridashëse: Gjyshi i tij është vrarë në mbrojtje të territoreve të vendit, që edhe sot e kësaj dite varri i tij ndodhet në Ulqin. Babai i tij ishte amaneti i dy prej figurave më të spikatura të kohës: Dan (Ramadan) Hasanit, pasaniku më i madh i kohës, dhe Dom Ndoc Nikajt, priftit, shkrimtarit dhe botuesit më në zë në atë periudhë. Vetë Ahmeti, i ardhur nga një familje e pasur, gjatë regjimit të kaluar, u caktua në detyra dhe pozicione shumë të rëndësishme, por pa qenë asnjëherë anëtar i partisë. Në vitet e tranzicionit, Ahmeti është përsëri një atdhetar, një idealist, një njeri i hapur e ndihmues për cilindo që i drejtohet.

Duke qenë një figurë komplekse, kaq e dashur dhe me kaq kulturë e njohuri shkencore dhe enciklopedike, jo thjeshtë në fushën e bujqësisë, por edhe për fusha të tjera të jetës, përfshi, traditën, folklorin, etnografinë, arkeologjinë, e sidomos gjeografinë e gjeologjinë, hidrografinë e pasuritë natyrore, monumentet e natyrës, njerëzit e punës e kështu në vijim.

Në këtë ceremoni kishte miq e dashamir të profesorit nga Shkodra, Tirana, Ulqini, Tuzi, Malësia e Madhe, Dukagjini, Puka dhe nga të gjitha anët e shqiptarisë.

Këta miq e dashamirë u bashkuan për të promovuar librin "Profesor Ahmet Osja – Mjeshtër i MADH – 80 vite jetë, punë, krijimtari". Vetë Profetori nuk ishte në mbështetje të idesë për një botim dedikuar atij vetë, por një grup miqsh të afërt të tij, vendosëm që të sjellim një botim, i cili është interesant si për ata që e kanë njohur Profesor Ahmetin, ashtu do të jetë edhe për ata që nuk e kanë njohur, si sot ashtu edhe për breza të së ardhmes. Libri flet për Profesor Ahmet Osjen: për jetën e tij, për librat që ai ka shkruar qoftë si autor, qoftë si bashkautor, për një pjesë të shkrimeve të shumta që ai ka, por edhe përshtypje e refleksione nga një sërë miqsh e bashkëpunëtorësh, që nga punëtori i thjeshtë e deri tek ish ministra, ish deputetë, e ish Presidenti i Republikës. Një libër, që megjithëse voluminoz, mbetet ende mjaft deficiatar për të pasqyruar gjithë rrugëtimin e Profesor Ahmetit. Edhe vetë autori i librit, miku i tij Zef Gjeta është i ndërgjegjshëm për këtë fakt, madje ai thotë me modesti se: "... kam sjellë në këtë libër, vetëm një pjesë të jetës, veprimtarisë dhe të krijimtarisë së Profesor Ahmetit!"

Në këtë ceremoni përshëndetën shumë dhe dhanë opinione për librin e jetën 80 vjeçare të profesor Ahmetit:

\*Profesor Rexhep UKA, ish- Ministër i

Bujqësisë dhe Zv/Kryeministër;

\*Profesor Doktor Sokrat JANI, kërkues shkencor, punonjës i Bankës Gjenetike, mik i hershëm i Prof. Ahmetit.

\*Edmond TËRTHORJA, Kancelar i UBT, përfaqësuesi i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Kancelar i këtij Universiteti, i cili pas përshëndetjes, dorëzoi titullin: "Nderi i Universitetit Bujqësor", dhënë nga Senati i UBT-së, profesor Ahmeti.

\*Naim LAÇAJ, përshëndeti, në emër të ish Institutit të Misrit dhe i Orizit, i cili ka qenë institucioni ku më së shumti ka punuar e kontribuar Profesor Ahmeti.

\*Profesor Ahmeti gjithmonë shprehet se "Zgjimi i Alpeve të Shqipërisë është zgjimi i Ballkanit", kaq shumë i do, i njeh e i vlerëson Profesor Ahmeti Alpet. Për to ka shkruar, ka botuar, ka nxitur iniciativa të ndryshme, e të tjera. Për të shënuar këtë kontribut të Profesor Ahmetit, Qendra "Alpe" i ka dhënë atij, të parit njeri deri më sot, vlerësimin: "NJERIU I ALPEVE", të cilin drejtuesi i kësaj Qendre, Ndoc Mulaj dhe njërin nga anëtarët e Komisionit dashamirës të Alpeve, Ismail BEKA, i dorëzoi këtë titull profesor Ahmetit.

\*Dy miq të Profesor Ahmetit, dy malësorë, Ilmi Kurti dhe Jonuz Delaj, kanë "kompozuar" një këngë, të cilën e interpretoi rapsodi Junuz Delaj

\*Profesor Ahmeti, veprimtarin e tij e ka filluar, në Dukagjin, ka punuar disa vite, ku ka lënë gjurmë e marrë mjaft "dije" dhe eksperiencë. Shoqata "Dukagjini", e ka vlerësuar Profesor Ahmetin me titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës" dhe në emër të saj përshëndeti Kryetari, Ndue Sanaj.

\*Një grup instrumentistësh, interpretojnë një pjesë muzikore për kënaqësinë e të gjithë pjesëmarrësve.

\*Dentisti dhe studiuesi Mark Bobnaj, një mik i hershëm i Profesor Ahmetit, përshëndeti dhe dha opinion për librin dhe profesor Ahmetin.

\*Gazetari Qemal SAKAJEVA, mik i Profesorit, përshëndeti Profesor Ahmetin.

\*Përshëndeti gazetar i bujqësisë, Skënder Sina dhe Inxhinierin e pyjeve Gjon Fierza.

\*Përshëndeti autori i librit dhe mik i profesor Ahmetit, profesor as dr. Zef Gjeta.

\*Në fund përshëndeti pjesëmarrësit, në këtë ceremoni dhe autorin e librit, profesor Ahmet Osja.

Pastaj pjesëmarrësit u ftuan në një koktej, që dhe në këtë rast nuk munguan opinionet dhe urimet për profesor Ahmetin dhe autorin e librit, Zef Gjeta, dhe foto të shumta.

Për një pjesë nga pjesëmarrësit, në hotel "Evropa" u shtrua një drekë, nga zoti Agron Çela.

Profesor Ahmeti, të urojmë sa të dojë zemra, me plotë shëndet e vital!

Redaksia





# ANALIZË E LIBRIT "PREKA I GJONIT": UNË VETËM GUXOVA, TË AUTORIT LEKË IMERAJ



I nderuar autor Z. Lekë Imeraj. Të nderuar pjesëmarrës, dashamirës të librit Përshëndetje të gjithëve!

Kur të gjithëve që jemi këtu na ka bashkuar libri me të drejtë mund të aprovojme thënien *"Libri ngelet dritare dhe anije e përhershme për të parë dhe njohur botën"*

Le të nisim atëherë udhëtimin tonë të njohjes të këtij libri për të cilin ndodhemi këtu sot që nga kuptimi i *titullit të librit: "Preka i Gjonit: unë vetëm guxova"*: është një titull simbolik: simbolizon aftësinë dhe kurajon e një personi në kërkim për tu bërë një njeri në kuptim metafizik dhe për të mbetur një njeri në kuptimin antropologjik gjatë etapave të zhvillimit të jetës.

Vijojmë me *strukturën e librit*: një ndarje interesante në kapituj që secila prej tyre përbën një pjesë të një puzzle për të formuar figurën e plotë të personazhit të cilit i është referuar autori i nderuar.

Stili i hapur i të shkruarit gjithnjë çon drejt pikëpamjes për librin si prodhim i veçantë artistik me funksion shoqëror; *teknikat e rrëfimit dhe përshkrimit* që përdor autori synojnë formën modeste dhe moderne njëkohësisht të paraqitjes pasi aty detajohen ambientet, portretet fizike dhe morale në funksion të karakterizimit dhe përgjithësimit.

Gjithashtu autori i nderuar ka përdorur analiza të ndjeshme psikologjike për të pasqyruar dhe motivuar rrugëtimin e personazhit gjatë situatave jetësore që ka kaluar.

Autori *ndjek linjën lineare të jetës* së personazhit por shpesh ka ndërlidhje fragmentesh përmes disgresionve që gjallërojnë zhvillimin e analizës psikologjike të personazhit kryesor për të cilin flitet.

Krahasimet dhe metaforat dominojnë në vepër por nuk mungojnë edhe figura të tjera letrare.

Kompozicioni i veprës është një personazh në të djeshmen, të sotmen dhe premisat për të ardhmen.

Heroi i veprës është një personazh i quajtur Preka i Gjonit.

Tani ju ftoj që të futemi pikërisht në pikën kulminante të librit: Kush është Preka i Gjonit? Kush është ai që vetëm guxoi? Cilat janë karakteristikat e personalitetit të tij që e spikatën këtë personazh?

Libri flet për ndikimin e jashtëzakonshëm të një personi me emrin Prekë për të cilin është shkruar kjo vepër që ka zgjatur për disa vite sipas autorit. Kontributi unik i sekuencave të jetës së këtij personazhi është shumë i madh, pasi që tekstet janë të

kombinuara aq bukur sa që mundësohet lidhja në mes të narratorit dhe lexuesit. Në këtë mënyrë krijohet vëmendja e lexuesit me zërin, ndjenjat dhe përjetimet edhe të vetë autorit sepse në raste të caktuara autori e vë veten në vend të personazhit.

Përveç aspekteve të thjeshta strukturore, *Libri* është i rëndësishëm për mënyrat nëpër të cilat lidh së bashku stilin klasik të të shkruarit letrar me ndërthurje antropologjike dhe psikologjike.

Jam e mendimit gjithashtu se autori është shprehur edhe nga pikëpamja filozofike dhe estetike ontologjike që konkretizohen me objektin estetik dhe funksionin metafizik.

Gjithashtu, konsideron se ky autor e pasuroi estetikën ontologjike me dimensionin historik të jetës së personazhit (*rrjedhat kronologjike por njëkohësisht nxjerr në dukje probleme bashkohore siç janë traditat, mendësitë krahinore, vështirësitë e mëdha ekonomike që kanë përjetuar familja e tij por njëkohësisht del në pah realiteti i shumë familje shqiptare dhe emigracioni i vështirë.*)

Kështu autori ka ofruar një këndvështrim të planit shpirtëror metafizik. Duke menduar si estetist, autori nis nga mendimi se qenia artistike, duke ekzistuar si fizis, si objekt më vete, përmban botën prej idesh dhe emocioneve, të cilat hyjnë në meta-fizisin e saj. Kështu, mendon se qenia bëhet e plotë. Do të thotë termi metafizikja këtu kuptohet si cilësi estetiko-metafizike që e përbën planin shpirtëror-metafizik. Kuptohet, kjo cilësi i përket vetëm veprave të mira artistike të cilat një lexues i vëren menjëherë pa ndonjë vështirësi. Në kuptim të parë ky libër zhvillon tri tema të mëdha: fëmijëria, rritja e parakohshme dhe vijueshmëria e jetës së personazhit.

Në *temën e parë* shtjellohet fëmijëria që nga kuptimi i lindjes së djalit dhe jetesa në fshatin Kllogjen, kuptimi bazë i gjenezës dhe traditave familjare, kuptimi i rëndësishëm së figurës mashkullore, del në pah ndjeshmëria e lartë karshi diferencimit gjinor, heroji kryesor që është babai si modeli i personazhit, ishte burimi i formimit të vetëdijes si mashkull, ndjenja e lartë e dashurisë dhe dhembshurisë për nënën e cila vuante nga kushtet ekonomike, familja e cila për të është shkolla më e madhe në të cilin një fëmijë ndërton bazat e karakterit të tij. Gjatë zhvillimit të tij kognitiv dhe socio emocional e shoqëron fakti se në familjen e tyre nuk bëhej fjalë për dëshira, vullnete, mendime të pavarura, mungonte liria e mendimit dhe fjalës përfshirë edhe martesat lidheshin sipas vendimeve të zotit të shtëpisë. Egërsia e jetës, armiku më i madh ishte varfëria, vuante në shpirt, fillimi i shkollës duke qënë në varfëri të madhe.

Në *temën e dytë*, autori i nderuar shfaqet me një lloj paradoksi që shpjegon më së miri vorbullën e ndjenjave nëpër të cilën po kalon personazhi. Në mënyrë figura-

tive ai e bën një lidhje në mes të të mundshmes dhe të pamundshmes sepse kemi të bëjmë me një rritje të parakohshme të një fëmije katërbëdhjetë vjeçar që po kërkon të mbajë peshën e familjes nbi supe për shkak se kërkon të gjejë një zgjidhje të gjendjes ekonomike në të cilën gjendet familja e tij. Kështu që mendon që të emigrojë në vendet si Greqia ku me kurajo të madhe i shtrohet punës duke bërë emër të përveçëm vetëm daljen nga vështirësitë që ka familja e tij në Shqipëri. Pasi që ndjenjat abstrakte mbizotërojnë në krijimin e rrëfijave emocionuese, autori i përdor ato me mjeshtëri kulminante. Kjo metodë bën që lexuesi të jetojë bashkë me autorin nëpër përjetimet e personazhit.

Në *temën e tretë* shtjellohen sekuenca të vijueshmërisë së formimit të personalitetit solid të personazhit i cili vazhdojë të kërkojë, duke testuar realitete të ndryshme për të gjetur drejtimin e duhur drejt një të ardhme më të mirë. Realitetet e lëvizin atë nga një vend në një tjetër siç është shteti i Italisë në të cilën kanë emigruar me mijëra shqiptarë apo Anglia, rikthimi në atdhe, vijueshmëria e punës së palodhur si një tregtar të devotshëm, vështirësitë me të cilat ndeshet, më pas martesja e tij, dhe të qënurit aktualisht një prind. Përmbledhtazi të treja temat përqëndrohen në: idealin e një njeriu që vështirësinë/ problemin e ktheu në artin e punës së palodhur-bukuria shpirtërore-motivimi konstant i përmirësimit të kushteve ekonomike. Tashmë nga një panoramë e përgjithshme do fokusohemi në diçka më specifike: veçoritë e personalitetit të personazhit.

**Këndvështrimi antropologjik:** Qëllimi i këtij personazhi me një natyrë humane është të realizojë një panoramë të realitetit, të veçantës dhe të përgjithshmes, të drejtpërdrejtës dhe konceptuale. Pavarësisht vështirësive, interesante është se ai gjithnjë guxon, duron, ka kurajo dhe e gjen zgjidhjen në atë mënyrë që të bëjë të duket diçka e zakonshme por njëkohësisht universale. Efekti atëherë qëndron në faktin se përpjekjet e tija të guximshme prodhojnë vepra që ofrojnë një pasqyrim më të vërtetë, më të plotë dhe më dinamik të realitetit, në krahasim me atë që zotëron receptuesi, çka e çon atë përtej eksperiencës vetjake, drejt një depërtimi më konkret në realitetin kohor.

**Këndvështrimi socio-psikologjik:** autori na bën të qartë se nuk kemi të bëjmë me një personazh të krijuar nga hiçgjëja por me një personazh real që hyn në galerinë e jetës. Autori, duke hedhur sytë në të kalurën e tij nuk mban një qëndrim nostalgjik dhe adhures ndaj fëmijërisë, përkundrazi, mban një qëndrim tipik, të cilin e shpreh nëpërmjet një keqardhjeje të hidhur dhe herë-herë nëpërmjet një shpjegimi therës. Herë herë autori tregon shtruar, zë një kënd dhe mediton, i jep të qartë lexuesit logjikën e fëmijës, të adleshentit dhe të rriturit duke përdorur

gjuhën e folur dhe duke zbuluar nga polita e të rriturit vlera të mëdha njerëzore.

Duke shkruar drejt fundit të kësaj kumtese, në këtë libër, sipas mendimit tim, gërshetohet e vërteta jetësore me të vërtetat artistike, duke krijuar një unitet ideo-artistik. Duke krijuar një galeri të tërë personazhesh, brenda një personazhi, autori nuk merret me skalitjen e tyre, nuk tregon thjesht historinë e formimit të tyre, por duke i vënë ata në situata dhe rrethana të caktuara, shpreh idealin e tij si person me karakteristika të spikatura pozitive si thjeshtësia, sinçeriteti, ndershmëria dhe mundi fizik të cilat shërbejnë si modele për të rinjtë por edhe për prindërit.

**Në mbyllje** mund të them se ky libër krahas të tjerave përbën për ne një dije kulturore ndër të tjera siç Gjorgj Ëashington De Long e përkufizon dijen kulturore si 'dija kolektive zotëron një komunitet' antropologët kulturorë Peoples dhe Bailey, theksojnë se dija kulturore i referohet 'qëndrimeve, ideve, besimeve, koncepteve, rregullave, vlerave, standarteve dhe perceptimeve të ruajtura më mendjen njerëzore'. Të gjitha këtotribute, thuaja se janë ind që formësojnë tekstin e shkruar dhe kështu e ka lënë tharmin krijues të marrë formën e padurimit krijues për të dalë në dritë pikërisht në këtë libër, i cili e ka titullin aq të ngrohtë, aq të afërt dhe përkushtues, *Unë Preka i Gjonit, vetëm guxova*. Pra, tashmë së fundmi, ne e kuptojmë se ky titull që ka madhësinë e thjeshtësisë por edhe të mesazhit shumëdimensional, në fillim sikur na u duk se është i sipërfaqshëm, mbase edhe i durimit të harxhuar. Por, përkundrazi, ai është titull që vetvetiu shndërrohet në kuptim të gjerë social dhe në sublim të madhësisë së jetës, të cilën, autori ka ditur të ngre në pedestal me tërë atë nektarin e të shkruarit.

**Si rrekomandim**, unë do të sugjeroja që ta lexoni këtë libër sepse libri merr peshë e vlerë për ta lexuar, për ta dashur e përjetuar, dhe pastaj për të ngelur si rrugëtimi që nuk ka kthim.

Kjo ndoshta, sepse ka rreshta që shumë prej nesh, mund ta gjejmë veten aty, mund të lidhim mendjen e shpirtin, edhe me lumturinë dhe me dhembjen që na përqafojnë edhe neve, bile, pa na pyetur për asgjë. Kjo, sepse, ngjarjet historike për njeriun janë pesha e dhembjes, por edhe e trembjes për shumëçka!

Meqë personazhi jep një model guximi, ndershmërie, dashurie dhe humanizmi nisur nga përvoja e tij rrekomandon *"Nëse nuk do të isha stërvitur në luftën e ashpër për të mbijtur në fëmijërinë time, madje që në djep, sot do isha një njeri i dështuar."* Kështu duhet vepruar, pa marrë parasysh që njeriu ndeshet me përplasjet e pashmangshme të realitetit, e që ndonjëherë, në të njëjtën kohë edhe dhembin dhe habitshëm edhe "ledhatojnë"!



# HISTORIA E LUFTËS KUNDËR MALIT TË ZI E VITIT 1915, NJË MUNOMENT I GJALLË KUJTESE



**Prelë Milani**

E dija se gjendej në dorëshkrim, u gëzova kur mësova se kishte hyrë në magje. Kishte kohë që prisja me interes të dilte nga “fura” e mora të ngrohtë dhe kapërdiva si uringuri simiten me djathë.

Ja fillova gjithë etje leximit, nuk ju ndava për një ditë e gjysmë, e putha me buzë kuq dhjetëra herë (nënvizimi me lapustil) dhe udhëtova 105 vite në kohën e shkuar.

Historia e Luftës Kundër Malit Të Zi. (Kujtime të vitit 1915 e At Bernardin Lllupit), është një autorrefim i vetëm dhe krejt veçantë i një regjisori, aktori, patrioti, trimi të pa epur, kleriku “mëkatar”.

Ky burrë inteligjent me zemër të madhe, vjen mrekullisht si rrufepritës e kronikan i krahinës së Nikaj Merturit në një nga ngjarjet më dramatike të fillim shekullit të 20-të.

Libri është vijim i traditës së shkollës letrare françeskanë. Daktiloshkrimin origjinal të kujtimeve të At Bernardin Lllupit, është ruajtur në arkivin Eilly Kamsit dhe është botuar sipas origjinalit dhe vjen një dhuratë e çmuar në kolonën e larmishme të literaturës françeskane, botuar nën kujdesin Frati Vitor Demaj.

At Bernardin Lllupi përshfaqet si personazhi kryesor anticiklonit malazez të verës së përgjakshme të vitit 1915.

Famullitari historik i Palçit, i mirënjohur edhe në Rapshe, Bize e Vlorë pas Luftës së Dytë Botërore, u gjet me shërbim meshtarak në Kosovë.

Atje u padit prej agentëve serb si propagandist shqiptar e antijugoslav, u nxor në gjyq dhe pushkatua nga komunistët, më 25 nëntor në vitin 1946, në Prizren, u tret në dhen e shqipeve pa varr të ditur. Ka gjasa se vrasja e tij erdhi si hakmarrje për veprën çmuar e të kahershme në shërbim të kombit shqiptar.

At Lllupi kujtimet e veta përjetuara në daktiloshkrimin e ja la me testamet historisë duke qenë kryefjala, ama, kronika dhe referenca përcaktuese e kësaj ngjarje, e cila per nga dinamika dramaciteti organizimi dhe bilancet nuk mund të konsiderohet aspak periferike.

Libri shpalosë më së miri personalitetin e një françeskani në mbrojtje të tokave shqiptare dhe bashkimin e malësorëve pa dallim katolikë e myslimanë dhe rreth flamurit të Shqipnisë gati me derdhë gjakun për mos cenimin e kufijve të vendit tonë.

Ky libër i munguar deri më sot është shkruar me stil elegant me gjuhë të thjeshtë, por mbi të gjitha i shkopsitur fund e krye nga hipokrizia, folklorizmi, dhe lule lajlet romantike duke na treguar me gisht se përpara Zotit dhe historisë as kush nuk mund të fshihet.

Jemi në vitin e parë të luftës më të madhe të përbotshme që kishte njohur historia gjer atëherë. Shqipëria ishte nuk

ishte gjë tjetër veç një drum i pa zot ku përplasnin brirët palët nder luftuese.

Më 7 qershor 1919 Vladomir Vesoviq, Gjenerali i famshëm malazez çoj një komision në Krasniqe nga ku kërkonte leje të kalonte nga Malësia e Gjakovës, nëpër Dukagjin për me ra në Shkodër.

Kjo kërkesë u refuzua nga Besëlidhja bajraqeve të “Malësisë së Gjakovës” e iniciuar nga patrioti ndershëm Bajram Curri

Në këtë kuvend morën pjesë të parët e Krasniqes, Bajram Mani, Bajram Nimani e Zeqir Halili, Isá Boletini i Kosovës; Zefi i vogël prej Gjakovet; Hasan Galica, kryetari i Komunës prej Rrjeket; Jah Sali i Bobaj, Osman Aga Kaskoçit, Halil Brahimi, Bajraktar i Gashit; bajraktarët e Nikajve dhe Merturit Tunxh Myftari e Sokol Basha së bashku me Man Avdinë, Prel Tulin dhe Balec Gjonin i Currajve të prirë nga At’ Bernardin Lllupi.

Më tu kthyer në Palç, me 9 qershor



1915 At’ Lllupi dhe krerët e Nikaj-Mërturit nisën përfaqësuesit e tyre më të spikatur per ftuar Shalën, Shoshin e Toplanën që t’i bashkëngjiteshin besëlidhjes së Malësisë së Gjakovës. Frati befahohet nga Jo-ja e Shalës dhe Shoshit, të cilat u shpjeguan mbasi Shkodra dhe Malësia e Madhe nuk po kundërshtonin as na nuk po ndahemi dhe nuk e shohim të arsyeshme ta kundërshtojmë shkjaun veç tanë Shqipërisë, ndërkohë që Toplana shprehu pa as një rezervë solidaritetin e saj.

Varka e kujtimeve të autorit të merr me vetë dhe dërgon në pa pritur në detin e trazuar të atyre ngjarjeve duke të befasuar e mbushë me kureshtje, i cili hap has hapi mëson diçka të re të pa thënë e shkruar më pare

Është ditë e premtë me 15 qershor 1915, malësoret ja zënë pritat shkjaun në Qafen e Morinë duke treguar trimëri e vendosmëri korrin frytet e para të bashkimit.

Çuditërisht shpalosja e flamurit kom-

bëtare nga kryengritësit e Nikaj-Mërturit ngjallë pëshqjellim te fanatikët e Gashit dhe Krasniqës, të cilët nuk mund qëndrojnë nën hijen bajrakut “me sorrë kauurre”. Hija e zezë 500 vjeçare otomane ua kishte verbuar sytë shqiptarëve, të cilët përsëri kërkonin ringjalljen e “babës” zemrat e liga dhe mëndjet e tyre të marrosura ishte ende i pa vdekshëm. Situata mund të precipitonte deri në tragjedi mes bajraqeve të krishtera dhe myslimane.

Zgjuarsia, drejtësia dhe vendosmëria e At’ Bernardin Lllupit i mbështetur nga Bajram Curri, që kishte ra ngushte e gjallë e frenoi një marrëzi që do bënte të harrohej turri i shkjaun.

Në kreun e tretë ndodhë çudia e madhe, “Besëlidhja e shenjtë” shkelet me të dyja këmbët nga ai që në memorien e kolektive shqiptare njihet si baca i pavarësisë.

At’ Lllupi ka shkruar të bardhen mbi të zezë”; - “Këtu ka tradhti burra!”

Jo pa hak këtë emër ja veshë Isa Bole-

pritat, por i a ndisi me dliirë shpijat e me hikë kahë të mujshin i madh e i vogel. Lufta vijote gjithnji më e rrebtë. Kúr Izá Boletini muer hiken e lshoi pritat pá kenë endë i ngushtuemë persë fortët prej Shkjaun, bâni disá me pasë dyshim a thue mos do t’kishte hanger para Shkjaun, tue u bâ marak tjerët, per ata të hikun të pa arsyeshem, tue ligstue edhe tjerët. Të hikunt e tij shkaktoi zhgatrrimin e luftës e kështu njani mbas tjetrit merrshin hiken pá dijte pshin. Mbas atyne atëherë edhe Zefi i Vogel me çetë të vogel të Begashit, qi ishin kund njiqind vetë, lshoi pritat e shkoi fill te Bajrami me i diftue gjithsesi arsyenë e të hikunit. Bajrami porsá pau Zefin e Vogel e muer veshit fjalët se ushtrija kishte fillue me u demoralizue tue lshue pritat e luftës; si muer veshit se Izá Boletini me gjith ata burra qi pat me veti, hiku, e tue pá se edhe Zefi dote me hikë me ta, i hini nji frigë e madhe, u zbë në fëtyrë e fryma filloi me i mungue. Ah! Ma paç faqen e zezë si na korite e na fike per së gjallit...” ( fq 42).

Pas këtij dezertimi tronditës, Bajram Curri më zemër të thyer detyrohet të marrë arratinë, ndërsa fleta e ngjarjeve me përmbysje kalon në anenë e shki-eve, të cilët në shenjë hakmarrje dogjën e zharitën Gashin e Krsniqën.

Me 15 qershor në Nikaj-Mërtur, që ishin dy brirëshi i qëndresës, Gjenerali malazez Vladomir Vasoviq e ndaloi tur-rin pasi u prit dhe gostit si mik nga frati Palçit. At Bernardin Lllupi nuk e hubi turn, nga partizani i flaktë i përdorimit të ush-tës, luajti me zgjuarsia kartën e pacifizmit të demagogut të rafinuar, duke i shprehur mirëkuptim, bindje, devocion dhe “dashuri”.

Një nga momentet më improsinante të librit, është dualizmi mes fratit e shqiptarit besnik nga njëra anë dhe trimit të laritur e nacionalistit të etur per shpagim dhe lavdi nga ana tjetër!

Në kohën kur Vasoviqi ishte në qelën e Palçit dhe gjithë oficerët në shtëpia ma të kamura të Parisë, frati mendonte që tu bënte gjëmën. Ata, tek e fundit kishin ardhur pa thirr jo si miq, por si zapti. Zogun e kemi në dore, të vrasim Gjeneralin dhe gjithë elitën udhëheqëse, që po hanin, pinin e bënë qef, ndërkohë që ushtrinë e mbetur si pula pa krye mund ta kosovitin si barin në kosë dhe kështu do nderonin vetën dhe Shqipërinë.

Planin heretik për një klerik u tregoi krerëve me lartë të dy bajrakëve, por Dedë Trimi, kushëriri i bajraktarit Merturit, Man Avdija vojvodë i Palçit dhe Prel Tuali eksponent me peshë në fis, nuk ju bindën frati, që gjithmonë ja kishin dëgjuar fjalën. Urtësisë së fratit në këtë rast nuk ju bindën. Kërrçate fisnik të maleve të kanunit nuk mund bëheshin aktor të një tragjedie heroike e denjë vetëm për çetë çetnike.

Frati i mbetur vetëm, atëherë filloi të zbatoj “plan B”, Vasoviqit i premtoj se jo vetëm që në Nikaj-Mërtur do kishte rrugën e lirë, por i dha edhe sihariqin se



tinit, i cili nuk është hera e pare që ka bërë gabime jo të vogla në qëndrimet e tij politike dhe ushtarake, ndërkohë që fatkeqësisht spiralja e historisë, përsëritet tekstualisht si me 1910 kur Gashi e Krasniqja i hapen rrugën Turgt Pashes, për të ndëshkuar me zjarr e me hekur Dukagjinin.

Për atë që nuk e njohin historinë ose kanë krijuar iluzione të gabuara nga lustrimet sipërfaqësore pa hyrë në thelbin këtyre ngjarjeve, fjalët e Lllupit i quan të rënda e denigruese. Jo, jo, At’ Lllupi ishte një intelektual i shkollës austriake, ishte një patriot mendjendritur, ai thotë vetëm të vërtetën. Shumë fatkeqësi janë bashkëudhëtare tona ndër vite nga frika për të thënë të vërtetën dhe vesi për të fshehur gabimet dhe fajet historike.

“Mbasi panë se Izá Begu Boletin me nja 70 vetë kishte lshue ballin e luftës e muer hiken, edhe tjerve u hini friga e lshunë pritat. Gashi por sá muer veshit hiken e Izá Boletinit, jo vetem se lshoj

të njëjtën garanci kishte marrë edhe nga Shala e Shoshi.

Gjenerali, jo vetëm që nuk mori as një masë ndëshkimore, por fali të gjithë ata që e kishin pritur me pushkë. At Llupi me zgjuarsi nga autoriteti tij suprem mori një letër garanci që konfirmonte, se ai ishte mik personal i gjeneralit.

Në kujtimet e fratit të Palçit Vasoviqi na paraqitet një kryekomandant i aftë i rreptë, i drejtë kalorsik dhe aspak mizore. Pa pikë mëdyshje i dha leje të mjekohej të plagosurit që Xhuj Aduli i Nikajve (Gjonpepaj) të cilit predha i theu të dyja këmbët në gju, cila rezultoi fatale pasi gjatë udhës për në Gjakovë shoqëruesit që po transportonin në vigranë në një pritë shkjeshë. Pushtuesit, në kokën e tyre në mënyrën më mizore i detyruan transportuesit të futen në pyll, ku ashtu të plagosur e pushkatuan, ndërsa shoqëruesit i lanë të ikin të tmerruar, duke lutur Zotin që nuk pësuan fatin Xhuajt. Kjo mizori shtazore e revoltoj pa masë At' Lluvin, i cili për këtë shëmtirë amonale do vente në dijeni për mes një personi Vasoviqin, i cili kur ndodhi ngjarja, gjendej në Shkodër. Derzhava e re instalohet në Nikaj- Mërtur, Novo Gilic, ishte autoriteti më i lartë, Komandanti i Malësisë së Gjakovës, pasuesit e tij ushtruan atributet e tyre në mënyrë të dhunshme, ndërsa At' Bernardin Llupi, mbeti gjithnjë një njeri i dyshuar, madje armik i regjimit të ri.

Ai me 30 qershor i shpëton mrekullisht një atentati. Në mendje, me zëmër e me veprime gjithnjë ishte një anti shkja, ndonëse ky me zgjuarsi proklamonte vetën si mik i Vasoviqit, për t'i shpëtuar ndëshkimeve krahinoreve të atyshëm. Ditët pasojnë njëra-tjetrën, teatri i ngjarjeve ngjason me një ndeshje finale futbollistike me shumë gola befasues, ku nga disavantazhi kalohet në përmbyse.

Nga ana tjetër e qafës Agërit vjen një flakadan shpresë, pikërisht Shala e Shoshi që nuk kish gjetur akordin për një besëlidhje me Malësinë e Gjakovës veç një muaj pas shkeljes së kësaj besë nga organizatorët, binjakët e Dukagjinit korren një fitore spektakolare duke thyer dhe zënë robër 1200 forca së bashku me komandantin e tyre Kostandin Nikiç, të cilët pa as një keq trajtim ishin lenë të lirë dhe i përcollën në besën fitimtarëve.

Pjesa e dytë e librit fillon me rrethimin dhe luftën kundër komandës së Nikprendajve, ku Kapiten Nikollën e shpëtuan këmbët e shpejta, malësorët e dy fiseve ortake gjithë hare dhe hov u vunë në ndjekje të malazezve, ku afër Qafës Kolshit pati një rrebesh shkëmbim zjarri. Kronikani ka regjistruar bilancet. U plagos djali Gjon Dedës prej Sermes së Toplanës, që kishte qenë mik në Mërtur, po ashtu edhe një djalë i Vllaznisë së Mirash Ndout të Vuksanajve.

Kreu i tret i pjesës së dytë të librit i kushtohet manovrës spektakolare të ditës së mërkurë, datës 7 korrik kundër Presjejdnikut në Curraj të Epër, i cili gjendej në Kishën e Currajve së bashku me ushtarët e tij

Nga pala malësore personazhet kryesorë të këtij dokumentari historik ishin, Balc Gjon, Nikë Musa, Gjon Bala, Syl Avdia, Gjeloš Rama dhe famullitari Pader Lenard Shajakaj me miratim dëshirën filloj sulmi mbi kishën e shenjtë, ku qën-

dronit të strehuar armiqtë e Shqipërisë.

At ' LLipi na tregon se në pushkët e para u vra një ushtarë, mandej Presjejdnikut dhe vartësit që nuk kishin lënë gjë pa bërë në popullin e Nikaj Merturit e tij u zinë rob së bashku me shumë sende stoli që kishin grabitur në popull. Urrejta ndaj tyre valonte, por me ndërhyrjen e Gjeloš Ramës dhe burrave të urtë fisit as kush nuk kreu as një veprim dhunë ndaj tyre, ushtar i vrrarë u varros denjësisht, ndërsa pese burra më krye Balc Gjonin përcollën Presjejdnikut dhe robërit e zënë deri afër Gucisë.

Në Shalë, Shosh, Nikaj Merturë, Pult e kudo robërit nuk ka pas djalë nane që i prekte pas, as kush nuk guxonte të përdoste besën dhe nderin e bajrakut.

Autori, kreun e katërt të pjesës së dytë të librit ja kushton Luftës së Qafës së Kolshit, e cila fillon flakë për flakë (07 korrik) pas duelit fitimtarë të Currajve të Epër. Duke shfrytëzuar kohën, terrenin dhe motivimin moral të dy sfidave në një pasnjëshme, vullnetare te dy barqet katolike ju reshen si anaxat Qafës së Kolshit. Autori i librit, duke qenë vetë prezent, madje një dinamit i ndezur në vijën e sulmit ka fotografuar gjithëçka duke ja lënë me testament historisë.

Në radhët e shkjeve mbetën të vdekur një major, prej Kaloshinit, tre kapiten, disa ushtarë të vrare dhe plagosur, të cilëve vetë autori i këtij ditari u mjekoi plagët, 17 ushtarë u bënë testemil (u dorëzuan), ku përveç armeve lëshuan edhe 26 arka të pa çelura me fishekë, një mitraloz, të cilin e përdori mjeshhtërisht Prend Hasani, rrogëtari dhe miku besnik i At' Bernardinit.

Jehona e kësaj rrufeje tronditëse gjëmoi në Gash, Krasniqe, Nikaj-Merturë deri përtej Drinit. Ndërkohë që nikaj mërtirsit vijuan ndjekjen duke shmangin rrugën për të mos shkelur mbi kufomat, ndërsa shkjet mori ikje të tmerruar, me britma e vaje sidomos të plagosurit.

*"Disa malazez, që mundën të largoheshin hynë në shpitë e Geghysenit, tu ra në dorë të Zotit e të tyre, e duke ba testemil armët, por këta të pa besë i mbyten të gjithë"*... Burrat e Krasniqes porsa panë se ikën shkiet nisen vjedhjen plaçkës që kishin lënë pas. ( fq. 124, 125). Nikaj-Merturësit i paralajmëruan të mos veprojnë ashtu dhe qe rrezik me krisë pushka mes këtyre fiseve, por paria e Krasniqes, kur pa se i hasi sharra në gozhdë u tërhoqën nga këto veprime të pa denja.

Autori është jo vetëm një regjisor, aktor, kronikan, por edhe një gjyqtarë i drejtë dhe i rreptë, i cili ndonëse nuk është historiani i luftës, në shkrimet tij është modeli më mirë i arkifakteve të ruajtura në frigoriferin e kujtesës historike.

Lexuesi i sotëm ka rast të shohë në revistë protagonistët e kësaj lufte, dhe të përbuzë me neveri të shiturit të pa vendosurit dhe të pa besët. Për këtë u nda më shenj prej të gjithëve Dush Basha (vëllai i bajraktarit të Nikajve nënvizon autori); Shyta Brahimi, Kreu i Gjonpepajve, i cili edhe u plagos; Ali Haka i Kapitit, që më pari hipi në qafë të Kolçit dhe vrau majorin malazez dhe më pas u flijua edhe vetë. Lista e gjatë e luftëtarëve të daluar vijon me Bek Selimin i (Nikprendaj); Smajl Sokoli i Mserrit; Kamer Prela (Lonodha i Nikajve), që u plagos rëndë;

Prend Hasani i Mëserrit (mitraljeri). Currajt patën një çete petritësh, petrite Balc Gjon, Gjeloš Rama, Gjon Bala, Pal Nika; Syl Avdia si rrufe gjarpëruan mes shtrëngatës; Man Avdija, vojvoda i Merturit; Kreu i Palçit Vuksan Vata, Zyber Babuni, Mirash Biceli, Kadri Cufa prej Kotecit; Prelë Tuli, kreu i Salcës; Cak Hoti e Sokol Toma (Salcë); Mark Sejdi Basha, kreu i Brisës; Tubxh Myftari bajraktari i Merturit; Zenel Selimi, kreu i Btošhës; Ukshin Bajrami, kreu i Mulajve, Sylë Marin Sylja i Markajve; Beqir Ndoui Vuksanajve së bashku me Mehmet Zenelin, Imer Michelin prej Rajet; Murec Sadria i Shëngjergjit; Ndrecë Muslia i Tetajve.

Në defterin e autorit si personazheve të kësaj sfide historike rezultojnë Mark Sadiku e Tahir Xhuri prej Pecajve të Shalës, Mirash Ndou i Vuksanajve, Marash Nikçi i shtëpisë së bajraktarit M, Mehmet Zeneli dhe Marash Vatam prej Abati.

Në luftime u plagos rëndë Vat Luci (vëllai i Ndosh Lucit) mbetën si bajrak nderi fushën e taksiratit Marsh Deli Kola dhe Nikë Deli Tahiri që At' Berndain Lupi, prijësi shpirtëror i gjithë kryengritësve ndanë shapin nga sheqeri kur nënvizon; "Se kjo luftë që u ba në qafem e Kolshit u ba prej popullit të Nikaj-Merturit, prej nja 10 shaljanve e një toplanasi, kërkush nuk mori pjesë prej Gashit e Krasniqes pos atyre prej Gehhysenit që u ndodhën gand në pyll t'ue pre dru (Sadik Arifi i Selimajve, Qerim Sheqeri, Mus Binaku, Sulë e Ali Zymeri dhe Murec Ukshin Abdylit) nga cilët mbetën të vdekur Sulë Ali Zymeri, Murec Ukshin Abdylit, ndërsa tre të tjerë mbeten të plagosur. Kreu i Mërturit të Gurit Dodë Prenkacoli, Pjeter Rahen e Appripës, Qerim Sokolkin e Bibgjonit, Syl Gjergjin e Fierit me 150 burra erdhe në ndihmë. Në radhët e kryengritësve i infiltruan edhe renegat të shitur si Osman Aga i Bashkocit. Ngjarjet marrin kthesë të pa pritur kur vjen lajmi i zi prej Shale e Shoshi se se fortësia dukagjinase ishte thyer dhe se shkretë kishin hyrë më duhi të përmbajtëshme në Pult Shalë e Shosh.

Të hënën me 15 korrik erdhi lajmi se devreja e Malit të Zi kishte dalë në qafë të Agrit. At' Llupi i këshilloj malësoret të tërhiqeshin, ide e cila u kundërshtua nga shumë eksponent malësore, por së fundi ashtu u bë pasi të hënën pas mesnatë, në drejtim të lindjes mësynë një ushtrie e madh malazezë e prirë nga shqiptaret renegat Osman Aga i Bashkocit dhe një farë Ceno Ali Begu i Gjakovës dhe Ali Hoxha i Geghysenit.

Kronikani i këtyre ngjarjeve detyrohet të marrë arratinë dhe strehohet në Berishë. Atje gjen koleget e tij, P. Çiril Canin famullitarin Shalës, P. Loro Miletën, e të Toplanës, P. Lonard Shajakun të Currajve të Epër dhe P. Nikollë Kolej famullitarin e Nikajve. Atje takohet edhe me patriotin njohur Dedë Gjon Luli.

Frati kalon episode dramatike në lidhje me fatin e jetës pasi dihej publikisht si njeriu që dirigjoi rebelimin anti malazez. Pas amnistisë së Kral Nikollës, At Llupi i dorëzohet të brigadierit të Mëhill Spacit. At Lupi me zgjuarsi e gjakftohtësi fitoi besim dhe mbrojtjen personale të Mëhill Spacit, por kudo ndihej i rrezikuar nga varësit e tij. Në qafë të Agrit grindet me një kapiten malazez, në Shosh rrugës për

në Shkodër takohet me Kapiten Tomën, të cilit i tregon letrën garancinë e Vasoviqit dhe se po udhëtonte drejt Shkodrës për të takuar direkt atë.

At' Llupi në Shkodër e pritën dy gjykime të rrepta. Së pari Vasoviqi i ftohtë, i prerë, por jo hakmarrësi i trego gjithëçka kishte bërë frati kundër forcave të tij duke përdorë kryqin dhe pushkën flakëruese. Frati që nuk binte lehtë në as një kurth u justifikua se në front kishte shkuar jo për të luftuar, por për të mjekuar të plagosurit dhe kryer sakramentet e fundit të vdekurve. Ai i tregon, se njëjtën gjë kishte bërë edhe për ushtarët malazez, të cilët u mjekuan, u ushqyen e u përcollën në besë, të vdekurit u varrosën njerëzisht.

Duke pas dekretin e faljes së Kral Nikollës, Vasoviqi nuk e ndëshkoj, por famullitari i Palçit humbi besimin dhe mbrojtjen e ti çfarë do thoshte se në atë situatë të rëndë pushtim nga çasti në çast mund i fluturonte kaptinë.

Interesant është edhe Gjyqi i dytë që priti para Provincialit, ku mori një ndëshkim të ashpër për veprimtarinë e tij luftarake anti malazezë (Ke shpërnda armë, dinamita, ke marrë pjesë me luftëtarët shqiptar duke vra malazez duke vepruar kundra ligjës së Zotit. Ti, në vend me përdorë kryqin e Krishtit me da të keq, ke prijë me bajrak popullit).

Ky provincial misionarë i Zotit, jo shqiptarë u tregua akoma më i ashpër se Vasoviqi. Qëndrimi i Provincialit nuk u mirëprit nga Patër Luigj Bushati, që foli dhe me At' Gjergj Fishten, i cili ndërhyri te dy definuar të tjerë. Pas 10 ditëve priti At Llupi i shpëtoi masës së rëndë, që parashikon rregullorja hierarkike kishtarë, por ai nuk mund të qëndronte më Shkodër. U nis, për në famullinë e tij, ku atje ndihej më i pa sigurt se kurrë, në Paç përjetoi një gazep të rëndë deri sa vendin e serbeve e pasuan austriaket.

At Bernardin Llupi më ketë libër, që la në dorëshkrim i beri një shërbim i për-vuajtur historisë kombëtare. Kujtimet e tija janë të vetmet dokumente shqiptare autentike dhe pa përsëritshme në lidhje me ketë ngjarje.

Autori, së pari është një patriot i flaket për të cilin para së gjithash qëndron Shqipëria pastaj veladoni i meshtarit.

Ai nuk pajtohet me qëndrimet pacifiste, ndoshta frikacake të disa kolegëve të famullive fqinjë, apo shpotitë me thumb At' Kamilo Libardit, fratit italian të Shoshit, i cili duke qeshë e prezanton me Kapiten Tomën duke i thënë;

*"Pasha Zotin që po të baj ky i ka pri popullit me luftue në Qafë Kolshit e vetë e ka shtrazë dinamitin dhe mitralozin kundra malazezve"* (fq.170)

Në ndryshim nga fretërit e Shoshit, Shalës, Kirit, Nikajve, Toplanës, Currajve, të cilët jo vetëm që nuk mëkatuan si ai duke u bërë pjesë e kryengritësve, por nuk morëm mundimin të shkruajnë as gjë në lidhje me këto ngjarje, që në Shalë, Shosh e Pult, që patën edhe intensitet më të lartë, por në burime të shkruar bashkëkohëse mbetën të pa ndriçuara

Historia e luftës kundër Malit të zi e vitit 1915, një munoment i gjallë kujtese për historinë e Nikaj-Merturit dhe krejt Dukagjinit, që në çdo situatë është orientuar nga mira dhe interesi i Shqipërisë.



# MARK PALNIKAJ: ZBULIME NGA DOKUMENTET E VATIKANIT, 5 SHEKUJ ËSHTË SHKRUAR SHQIP

Dhurata Hamzai

Në vitet 1600-‘700 janë përgatitur 206 shqiptarë në studimin e shqipes në Kolegjin Ilirik të Loretos dhe të Feros në Itali, i cili qëndroi i hapur deri në vitin 1746.

“Arbënor i dashur, këtë gramatikën e shkrova për zotninë tënde”.... Edhe sot pas 4 shekujsh, kjo e shkruar e Andrea Bogdanit, që la amanet botimin e gramatikës shqipe, mund të transkriptohet lehtë në gjuhën e sotme shqipe. Janë qindra si këto dokumente që plotësojnë hendekun e atyre pseve për mungesën e shkrimit shqip gjatë pesë shekujve të pushtimit osman.

Për studiuesin Mark Palnikaj është fakt që; në pesë shekuj shkollat dhe gjuha shqipe janë në një vijimësi të pandërprerë. Ai argumenton me një seri dokumentesh në një intervistë për gazetën “Shqiptarja.com” vijimësinë e tyre gjatë pesë shekujve nën sundimin osman, deri në 1905-n kur u mor vendimi për çeljen e shkollave tërësisht në gjuhën shqipe. Osmanët e luftonin gjuhën dhe shkollën shqipe, por shqiptarët sakrifkuan dhe i mbajtën gjallë, duke u bërë ruajtës të identitetit tonë. Mark Palnikaj është aq entuziast pas zbulimit të çdo dokumenti që flet për çelje të shkollave shqipe që nga Shkodra, në Shkup, në Mal të Zi e deri në Prevezë; nga ‘500-a në ‘600-n e nga ‘700-a, në ‘800-n e 900-n. Por, dje, duke përshëndetur nga Vatikanit, ku po kërkon arkiva të reja Mark Palnikaj tha: “Kam gjetur plot gjëra, por këtë herë jam mërzhitur... sesa pak dimë për historinë tonë”. Ndërsa në intervistën për “Shqiptarja.com”, ai rrëfen për dokumente e shkolla të njohura e të panjohura, duke na tërhequr fort vëmendjen e duke e plotësuar mozaikun e njohurive mbi këtë temë.

**Bashkebisedimi:**

**Zoti Palnikaj, ju shkoni shpesh në Arkivat e Vatikanit, e sot që po flasim jeni aty. Përveç dokumenteve në latinisht që lidhen me historinë tonë, ju nuk reshtni së reklamuari zbulimet e dhjetëra dokumenteve të shkruara në gjuhën shqipe përgjatë shekujve, nga 1500-a deri në fundin e 1800-s. Çfarë rëndësie historike kanë dokumentet e zbuluara?**

- Me këto dokumente unë dua të zbuloj të plotë historikun e shkrimit të gjuhës shqipe dhe të shkollave shqipe në trevat shqiptare. Për historikun e shkollave shqipe janë mbajtur një numër shumë i madh konferencash madje edhe kongrese dhe janë botuar shumë libra dhe studime ku janë identifikuar kontributet e të parëve tanë arbëror për shkollat dhe shkrimin shqip qysh nga shekulli XIII e këtej. Edhe

studiuesit shqiptarë e shumë studiues të huaj kanë sjellë të dhëna për shkrimet e para në gjuhën shqipe dhe për shkollat e para në trevat arbërore, para se të formohej shteti shqiptar. Por nga studimet e kryera vitet e fundit, sidomos nga viti 1930 e deri më sot, është zvogëluar roli i shkollave shqipe të hapura nga klerikët tanë të nderuar deri në shekullin XIX, me pretendimin se “ato kanë qenë shkolla fetare”. Një mendim i tillë më duket shumë i padrejtë sepse në të gjithë kontinentin evropian shkollat e para janë hapur në



fillim nga institucionet fetare. Në trevat shqipfolëse të asaj kohe vetëm priftërinjtë kishin arsimin e nevojshëm për të mundësuar lëvrimin e gjuhës shqipe të asaj kohe dhe ata klerikë ishin kryesisht shqiptar, por në ndonjë rast, kontribute me rëndësi dhanë edhe klerikët me kombësi jo shqiptare që shërbyen në Shqipëri. Barleti, Beçikemi, Dhimitër Frangu, Buzuku, Bardhi, Bogdani, për shekujt XVI dhe XVII, na kanë lënë monumente me rëndësi në këtë fushë duke na dhuruar veprat e pavdekshme të historive për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriotin Skënderbeu, “Mesharin”, Fjalorit Latinisht Shqip, Doktrinën dhe vepra të tjera të prezantuara dhe të njohura në shumë punime të mëparshme. Sipas burimeve arkivore na fletohet se Stublla e shqiptarëve të Malit të Zi pati shkollën e parë shqipe që në vitin 1584, e qe vijoi deri me 1 shkurt të vitit 1905, kur u shpall famulli më vete. Ishte filial i Letnicës. Data 5 shkurt, ndërkaq shënon fillimin e semestrit të dytë të vitit shkollor 1904 – 1905, tashmë të Stubllës së pavarur nga Letnica. Komuna e Vitisë datën 5 shkurt e ka futur në Statutin e Komunës si ditë feste të Shkollës Shqipe.

**Ndërkohë ka një opinion në popullsinë e gjerë se shqip është shkruar pas themelimit të Alfabetit të Manastirit 1908. Ndërsa në rrethet akademike ka pasur një studim të kufizuar në fakte si Formula e pagëzimit e Pal Engjëllit**

**dhe “Meshari i Gjon Buzukut” (1555). Cilat janë shembujt më të parë që do të sillnin fakte për një shkrim të pandërprerë të shqipes gjatë shekujve?**

-Unë mjafton t’ju kujtoj disa shkolla prestigjioze të shekujve të kaluar ku mësohej shqip. Përmend këtu kolegjin ilirik të Loretos, që është hapur në vitin 1555 e që përgatiste klerikë për Ballkanin dhe rajonin e pushtuar nga turqit. Një pjesë e shqiptarëve përgatiteshin për ritin grek ortodoks dhe një pjesë përgatiteshin për ritin latin, kishën katolike romane, që

të përmendura më sipër, gjatë kësaj kohe në këtë kolegji u regjistruan 82 shqiptar nga të cilët 10 prej tyre arritën në postin e Ispeshkvi në ipeshkvi të ndryshme në trevat shqiptare. Në vitin 1627 është hapur Kolegji Urban pranë Propagandës Fide në Vatikan i cili me ndërprerje të shkurtra ka qëndruar i hapur deri në vitin 1931. Edhe këtë kolegji e mbaruan shumë persona të ardhur nga Arbëria, Tivari dhe Kosova. Numrin e saktë për personat që e mbaruan këtë kolegji nuk e kemi por edhe këtu një numër i madh shqiptarësh kanë studiuar gjatë kësaj kohe. Mbas marrëveshjes midis Perandorisë Austriake dhe Vatikanit të vitit 1837 në kolegjet dhe universitetet e Austrisë u dërguan për të studiuar një numër i konsiderueshëm i studentëve nga Shqipëria.

Zanafilla e shkollave në gjuhën shqipe është mbas krijimit të urdhrit të Jezuitëve të cilët shkollimin e besimtarëve e shikonin si nevojë të dorës së parë. Ata vunë themelet e arsimit modern evropian, ku pikat themelore ishin hartimi i programeve shkollore që deri atëherë ishin të panjohura, arsimimin falas dhe arsimimi edhe për fëmijët e familjeve të varfra. Jezuitët hapën shkollat fetare më në zë në kontinentin evropian dhe disa nga figurat më të rëndësishme në lëmin e shkrimeve shqipe të shekullit XVII si Frang Bardhi, Pjetër Bogdani e të tjerë mbaruan pikërisht këto shkolla. Në trojet shqiptare ky urdhër fetar u paraqit vetëm në vitin 1841. Në traditën treqindvjeçare të tyre për arsimimin e besimtarëve, ata hapën në Shkodër Kolegjin Saverian, njëherë nga shkollat më prestigjioze që është hapur në historinë e këtij qyteti. Ata e mbajtën gjallë këtë vend dhe nëse kemi 124 prej tyre e 84 që mbaruan Loreton, këta e mbajtën gjallë kombin shqiptar, gjuha shqipe është bërë nga ata. Një tekst gjuhe me 274 faqe nuk kemi sot në shkollat tona. Jemi në fillimet publikimit se i ka mbuluar harresa

**Cila ishin disa nga emrat?**

-Janë shumë. Andrea Bogdani kishte hartuar një gramatikë të gjuhës shqipe, por ajo humbi në mënyrë aksidentale pa u botuar nga nipi i tij, Pjetër Bogdani.

**A mund të gjendet në arkiva kjo gramatikë?**

-Jo nuk e besoj. Sepse ka qenë për përdorim nga studentët dhe mund të jetë shkatërruar. Por në dokumente të tjera të Arkivave të Vatikanit, flitet gjithnjë e më tepër për ekzistencën e saj. Hartimi i kësaj gramatike dhe i Fjalorit të Frang Bardhit tregon se në mesin e shekullit XVII ishte kërkesë e kohës mësimi i gjuhës shqipe në stil të gjerë. Siç do ta shohim më poshtë, në shekullin XVIII lëvrimi i gjuhës shqipe merr përmasa edhe më të mëdha me hartimin e gramatikës dhe të fjalorit shqip nga Maria da Leçe në vitin 1716, hartimi i gramatikës shqipe nga dom Pal Zogaj në vitin 1776, ►



# NDUE PAL SHLLAKU, POETI DHE ARTISTI I HESHTUR

*Profili i një artisti të veçantë, me karrierë të spikatur si aktor, por që ishte edhe një poet drithërues.*

*Çfarë fshehin fletët e një arkive me shumë fakte e dëshmi të rralla rreth këtij artisti...*

Emrin e Ndue Pal Shllakut për herë të parë si aktor amator në Shoqërinë Antoniane, e "takova" në librin me kujtime "100 vjet teatër në Shkodër" (1879 – 1979) i autorit Andrea Skanjeti. Më vonë mësova se aktori Shllaku kishte edhe disa interpretime të tjera në skenat teatrore të kësaj shoqërie, ku kishte realizuar disa personazhe. Plotësime të mëtejshme të biografisë artistike të Ndue Pal Shllakut i gjeta, më vonë, edhe në shkrimet e studimet e aktorit Gjon Karma, Artist i Merituar, në gazetën "Tomori" dhe "Tomori i vogël", si dhe në arkivin e njohësit të historisë së teatrit të Shkodrës, Gjush Sheldia.

Nga studiuesit mësojmë se, Ndue Pal Shllaku hyri në Shoqërinë Antoniane rreth viteve 1935 – 1936. Si interpretues në fushën e aktrimit lë shenjë në komedinë "Shjor Puci" (komedi në tre akte) me autor Zef Gianini, përkthyer nga Dom Lazër Shantoja. Është për t'u përmendur se në këtë shfaqje ishte i pranishëm dhe poeti Gjergj Fishta. Më vonë, dhe është qershori i vitit 1941, kur Ndue Pal Shllaku mban një fjalim në përkujtim të këtij poeti të shquar. Gjithashtu, Ndueja interpretoi edhe në dramën me tre akte "Kur orët lajmojnë" të Ernest Koliqit, (të cilën vetë e përpunoi dhe vetë luajti per-

sonazhin e Gegë Markut); në farsën "Loja e mijvet, gazmendi i dacave" (komedi, përpunuar nga Çesk Vuksani). Jo vetëm kaq po Ndueja luajti rolin e Sulejmanit; te "Sekretari esnafë" (komedi me një akt), luajti rolin e Palushit. Në muajin prill të vitit 1941 luan personazhin kryesor në tragjedinë me pesë akte "Thomas Moore" të Silvio Pelicës (dramë e përkthyer nga padër Agustin Ashiku), e cila si premierë u dha në vitin 1941. U shfaq katër herë me 1200 spektatorë. Ndërsa në tragjedinë me një akt "Një natë tragjike" (dramatizim nga Ndue Pal Shllaku) mbështetur në kapitullin "Gjak Romanjolas", shkëputur nga libri "Zemra" i E. De Amicis; vetë Ndueja luajti rolin e plakut (gjyshit). Po në këtë muaj me rastin e festës së kësaj shoqërie, interpreton në komedinë me një akt "Mnistari" (përkthyer nga italishtja e përshtatur në shqip nga At Silvestër Hila). Këtu luan rolin e doktorit. Më pas interpretoi në komedinë me një akt "Gjyqi" me autor padër Frano Kiri. Premiera u dha më, 16.04.1936 me këto interpretues: Lin Gjonej, Gjon Karma, Ndoc Harapi, Pjetër Gjoka, Gaspër Bicej, Shan Zadrima, Ndue Pal Shllaku (në rolin e gjykatësit dhe ishte 14 vjeç). Ndërsa interpretimi i fundit është në tetor të vitit 1941, në dramën

me pesë akte të titulluar "Ferdinandi i Agrigjentit", e cila u shfaq pesë here. Ndue Pal Shllaku interpretoi rolin e Ferdinantit. Duke parë afirmimin e personalitetit të tij si aktor e si krijues, interesat e tij artistike erdhën gjithnjë në rritje. Kështu Ndueja rreth viteve 1940 – 1941 u zgjodh sekretar i Shoqërisë Antoniane. Krahas rrugës aktorese e asaj fillestare në rrugën e dramaturgjisë (nëpërmjet dramatizimit), djali nga Shllaku fshihte thellë në shpirtin e tij tragjik dashurinë për letërsinë.

E dashuroi atë si vetë ëndrrën për të ëndërruar, e dashuroi atë si vetë jetën për të jetuar. E kishte kredo të viteve që i kishin mbetur për të jetuar. "Me kangë të shpirtit tim këndon edhe jeta" dhe më tej Ndueja vazhdon: "... shpirtin... qi vuejti përherë në heshtje". E ky njeri me shpirt njeriu, mori një dimension të ri e befases në hulumtimet e studimet e mia. Shkas u bë, një ditë vjeshte, një bisedë krejt e zakonshme me ish aktoren e talentuar të teatrit "Migjeni" Antoneta Fishta (tashmë e ndarë nga jeta), në shtëpinë e saj.

Teksa unë interesohesha për jetën e saj artistike në fushën e aktrimit, ajo më përmendi emrin e Ndue Pal Shllakut, ashtu krejt rastësisht, nga që biseda me ish aktoren e mirënjohur, tashmë, kishte hyrë

në hullinë e vlerave të panjohura që ende i ruan qyteti ynë. Unë mbeta për një çast i habitur. Për momentin pranova heshtjen dhe në heshtje gërmova në kujtesën time. I tregova se çfarë dija për personazhin që përmendi pak më parë. Ajo qeshi, me atë të qeshurën e saj karakteristike e paksa burrërore dhe njëkohësisht më befasoi, kur me bujarinë, dashamirësinë e fisnikërinë e saj më vuri në dispozicion arkivin e tij letrar. Tani "do të bisedoja" me faqe të shkruara e të panjohura (poezi, prozë, studime, etj.), ku shpaloseshin konceptet estetike dhe botëkuptimi i tij, qëndrimet dhe shtysat, motivet dhe realiteti i krijuar prej tij... "T'falëm o diell vezllimesh! / E ju rreze të shkëlqyeshme. / Që n'hare puthni mallet / N'largim për i dit' dëfrimesh / Që agon me ngjyra t'ndryshme! / Plot zemër e gjith i botë u falet!" (Diellit..., autori: Ndue P. Shllaku, botuar: Tomori, 05.06.1942)

Zj. Fishta më përmendi edhe një amanet: "Im shoq, Lec Fishta e ka ruajtë me kujdes e dhembshuri për 50 vjet me radhë. Me shpresën për ditë më të bukura, me besimin se një ditë do t'ia jap lexuesit të gjitha këto". Dhe unë pas një pauze të shkurtër i thashë se do të vijë një ditë që zëri poetik i Ndue Pal Shllakut do të bëhet

nga funksionimi i disa shkollave në trevat arbërore etj. Për arsimimin e klerikëve shqiptar para vitit 1584 kemi pak të dhëna të shkruara.

## -Çfarë faktori i ka fshehur të dhënat?

-Kujtojmë se viti 1479 përkon me pushtimin osman të Shkodrës dhe trevat shqiptare të përfshira në dioqezat e Shkupit dhe ato arbërore u pushtuan nga osmanët. Ndaj, jeta kishtare për besimtarët katolik ka qenë shumë e vështirë. Pushtuesi ka shkatërruar pothuaj të gjitha kishat dhe ka propaganduar si fe zyrtare fenë islame, ku mendohet të jenë djegur dhe dokumente të çmuara. Por edhe ndihma nga ana e Selisë së Shenjtë për këta besimtarë ka qenë minimale në këto kushte. Në vitin 1555 është botuar në gjuhën shqipe Meshari i Gjon Buzukut. Ky veprim nuk mund të konsiderohet një rastësi, sepse në atë kohë botimi i një libri të tillë nga një prift pa mbështetjen dhe sponsorizimin e institucioneve më të larta fetare, ka qenë absolutisht i pamundur. Ka një hendek këtu nëse kujtojmë se shkolla ka pasur edhe më herët si shkolla në Ulqin (1258) dhe në vazhdim në Durrës (1278), dy shkolla në Shkodër (1345 dhe 1395), në Tivar (1349), në Pult (1367), në Drisht (1396), duke vazhduar në shekujt XV-XVIII me shkolla të tjera në Shkodër, Lezhë, në Stubëll (1584), Trafandinë, Kunavi, Dibër, Prizren, Shkup, Elbasan, Ohër etj. Këto të dhëna dëshmojnë se në ato shekuj të shkuar, kisha katolike albaneze me françeskanët në vijën e parë, i zhvillonin të gjitha ritet fetare në



gjuhën albaneze, andaj populli i frekuentonte kishat e kuvendet me dëshirë, duke marrë pjesë aktive në meshat, pagëzimet, katekizmat, kresmat, në celebrimin e martesave etj. Jo vetëm kaq, por françeskanët kontribuan dhe në hapjen e shkollave në gjuhën albaneze. "si më 1416 shkolla në Shkodër. Dokumentet e zbuluara shkruar për këto shkolla, ja njëri prej tyre: "La scuola overo frataglia de Santa Barbara; la scuola overo frataglia de San Mercurio; la scuola overo frataglia de Santa Croce." (shkolla e vllaznve të "Shen Barbara";

shkolla e vllaznve të "Shen Merkurit"; shkolla e vllaznve "Kryqi i Shenjtë" – e përshtati nga italishtja në shqip – Bep Martin Pjetri). Në vitin 1584 u themelue Shkolla shqiptare nga klerikë katolikë në Stubllë (afër Gjilanit- fshat i Malësisë së Karadakut) i njohun si Kolegji i Shën Lukës në Kosovë. Në vitin 1632, hapja e shkollës shqipe të Kurbinit nga Imzot Gjon Kolesi. Në vitin 1638, Etërit Françeskanë hapën një shkollë në Shkodër dhe në Pllanë. Në vitin 1639, Fretërit e Troshanit hapën shkolla në Blinisht dhe

në Zadrimë. Krijimi i këtyre shkollave në gjysmën e parë të 600-ës rrjedh nga një interes i ndjeshëm për zhvillimin e arsimit. Arqipeshkvi Pjetër Mazreku nga Prizreni në raportet e tij (të shkruem në vitet 1632-1633) (thekson) rolin e shkollës dhe nevojën e shkollimit të shqiptarëve. Më 1698, Padër Filip Shkodra çeli shkollë në familjen Kamsi, në Shkodër. Në vitin 1885 në Prizren, gjejmë një shkollë filllore shqipe për vajza. Më 1858-n në Kushë Micja u çel shkolla për vajza shkodrane. Në vitin 1861 françeskanët çelin më të parën shkollë fillestare publike në Shkodër.

## Pra, shkolla shqipe janë ngritur pa ndërprerje, nën peshën e rëndë të sundimit të gjatë osman?

-Sigurisht që vijon pa ndërprerje. Për çdo shkollë të çelur ka dokumente në Vatikan. Viojmë me shkollën në gjuhën shqipe më 1874, ku u çel shkolla e Parë Laike e Kohës së Rilindjes, ku mësohet Gjuha Shqipe E Arithmetika e Shirokës nga Dom Zef Ashta. më 1879 Motrat Stigmatine çelin më të parën shkollë filllore për varza e, ma të parën shkollë për punësimin. Aty u rritën me kujdes, jo vetëm zonja shtëpijash, por edhe nëna shqiptare. Këto shkolla mund të thuhet, se poqën mendimin për themelimin e një shkolle publike femnore. Më 1882 françeskanët çelën një kolegji për ata që dëshironin me u ba fretën. Mësimet ishin të rregullueme mbas programit të gjimnazeve të Austrisë e më 1905-n shkollat u bënë krejt në gjuhë shqipe...



i njohur.

Materiali i shfletuar me kujdes, më ofron ndjesinë e kohës së humbur e njëkohësisht kohës së fituar. Nocioni i kohës, i raportit të saj me autorin, me sensibilitetin e fluiditetin moshor, shpirtëror, që ruan e kondenson herë një romantizëm engjëllor e herë një romantizëm shpresëvakët e shpesh pesimist, mbeten dukuri të veçanta e interesante që vijëzojnë individualitetin e tij krijues si fllad ngjashmërie kah Gaspër Pali e si revoltë ndaj padrejtësive kah Migjeni. I themi këto se si poezia ashtu edhe proza (përshtirë edhe temat hartimore, esetë, etj.) janë reflekse të dalë prej shpirtit të tij, prej dhimbjes burimore të tij. Nuk e ke të vështirë të kuptosh se kemi të bëjmë me një shpirt të ndryem brenda shpirtit të vet përherë ndër vuajtje, si një shembull i durimit në heshtje, apo siç thotë vetë poeti: “Kje diçka, një i luftës kundër valëve të jetës”. Kësaj të vërtetë të dhimbshme janë dëshmitarë të heshtjes shumë vite të jetës së tij, që e vunë në prova e rrethana shumë të vështira, por Ndueja me kurajo, me vullnet pse jo nganjëherë edhe me nota dëshpëruese, por me guxim moshe u mundua t’i kapërcejë. Ndonëse viti 1942 nuk ishte i mbarë, i jetës (ishte caku i fundit i të jetuarit) për Ndue. Në këtë gjendje të vështirë shëndetësore, ku shpirti i tij ende ruante si margaritar dashurinë për jetën, Ndueja me forcën e sublimitetit të shpirtit shkruan pa pushim... Dhe muajin e fundit e kuptoi se lulet dhe diellin e qershorit nuk do të arrinte t’i shihnte më. Jeta për të çdo ditë vakej, tashmë ishte një shpresë e kotë... Megjithatë ai vazhdonte të shkruante... ashtu i shtrirë në copa letrash e në faqe të plota. Edhe pse dora dridhej e fjalët ishin të pasigurta. “VORFNIJA asht një grue e shkretë / Me zemër plot mjerime; / Gjithmonë udhton ndeshprime, / Shpesh t’mson me e gzue kët jetë. / PAS’NIJ’ a’j zojush’ e terbueme; / Të knaq’njat-her’ kur e ke, / Me t’ikë, at-her’ i mjer’je / Vishtir’më ba ma t’hatrueme.” (VORFNIJA e PASUNIJA, autori: Ndue P. Shllaku, poezi në dorëshkrim)

E ndarja nga jeta e Ndues, në at’ vjeshtë me “qiell të vrasuemun”, lë gjurmë frymëzimi, dashurie dhe përjetësie të një autor me pseudonimin ‘Lodja’, ku i kush-ton Ndues, këtë poezi mortore: “Krahasoj prendveren t’ime: / Me vjeshtën që don me ardhë / Me jeten që Ty t’a mardhë, / Me naten që s’ka m’u zbardhë / Kurr ma. // E lott m’rrjedhin heshtueshem / N’per zemren e gandueme / N’per mollxat e zverdhueme / N’per vargjet e vorfnueme / O vlla. (Vjeshtë!.. -kushtue Ndue P. Shllaku-, autori: Lodja, gaz. Tomori, 24.11.1942)

Teksa shfletoj arkivin e krijuesit në fjalë, ndiej se koha e ka humbur nocionin abstrakt të saj dhe tani është konkrete e reale, mirënjohëse dhe fatlume. Shumë fletëve të dorëshkrimeve u bie pluhuri, por nuk u ikën ngjyrat e verdha dhe të vjetërsisë së tyre, paçka se vende-vende detyrohesh të punosh edhe me lupë, falë një dhurate të çmueshme nga ana e mikes sime, Dirës, e cila i kuptoi menjëherë vështirësitë e mia dhe hallin se si punoja... Por nuk e kishe të vështirë të vështirë para krijimeve të autorit Ndue Pal Shllaku, se ajo vlerë që tani ndodhej para meje, që në “komunikimin” e parë të impononte res-

pekt, sepse ishte shkruar me një shkrim të bukur e të admirueshëm (që vërtetë kishe zili), se ishte shkrim i tipit bukurshkrim (tashmë i harruar në shkollat tona), grafi që ta japin vetëm shkollat serioze, siç ishte ajo e Kolegjit të Françeskanëve dhe ajo e Gjimnazit të Shtetit, ku krijuesi nisi udhën e dijës me plot ëndrra, e udhën fisnike të letrave shqipe me plot talent e dëshira,



por që nuk u realizuan dot, se vdekja e mori atëherë kur nuk duhej ta merrte: në moshë rinore, 20 vjeç. Krahas botimeve në gazetën “Tomori” e “Tomori i vogël”, në revistën “Zani i Shna Ndout” e në fletoren “Sporti shqiptar”, Ndue Pal Shllaku la mjaft dorëshkrime të botuara, si: 30 poezi, 10 novela e novelëza, një ditar, një përrallë dhe shumë përkthime, ku mund të veçojmë dramën “Mbas njimdhjet vjet”sh” të autorit italian Camilo Federici. Është për t’u përmendur edhe puna që nisi me një dramë origjinale të titulluar “Omeri i ri” që arriti deri te akti i parë, pasi sëmundja nuk e la që të vazhdonte më tej. (Poezia, proza dhe dramaturgjia do të jenë shqyrtime të studimeve të mia të ardhshme.)

Duke iu rikthyer botimeve, vërejmë se shkrimi i parë mban datën 7 janar 1939 dhe titullohet: “Kujtime” (botuar në fletoren “Sporti shqiptar”), ndërsa vjersha e fundit mban titullin “Jeh i vetmuar” (botuar në gazetën “Tomori”, në vitin 1924). Në këtë gazetë ka botuar poezitë: “Muzg vjeshtë”, “Ushtima”, “Mramja”, “Hanës” dhe novelën “Kulla e çekiçi”. Kurse në revistën “Zani i Shna Ndout” boton novelën “Streha dëshmuese”.

Ndoja lindi më 25.02.1922 në Shllak. Ishte biri i Pal Vuksanit dhe i Katrinës (i thoshin dhe Kate) së Kolë Ndout, e cila ishte bijë prej Dushmanit. Babai i vdiq shumë herët dhe nuk e njohu atë. Ndoja ishte një vjeç. Më vonë poeti i ardhshëm do të shkruante në ditarin e tij: “... që në fëmëni dishroj babën. Trupi i tij përkundej në shpinën e ngarkuese të s’amës. Kjante e veç lotët e syeve tue rige mbi mollza ia lmojshin faqet Ndout ferishte. Strehë pushimi dituer për Ndoun, ishte ndo’ i hije peme nder ara të zharituna ku e ama punonte për t’ushqye vedin e të voglin e sajë. Atë nuk e lmuen kurr duer delikate; por dy duer të vrazhda pune po shumë të dashura nane. Kangë gjumi ishte për të zani i natyrës”.

Rreth viteve 1924 – 1925 së bashku me nënën i dhanë “lamtumirën” Shllakut, (ku e ëma përpiquej të siguronte kafshatën e bukës) dhe zbritën për të jetuar

në Shkodër, (ku e ëma punonte aty-këtu dyerve të panjohura për të siguruar minimumin e jetesës.) Ndueja, tashmë, ishte tre vjeç.

Strehohet për mëshirë në një dhomë përdhese të një familjeje bamirëse shkodrane. Dhe për Ndue e vogël strehë ditore bëhen Motrat Servite, ku ai merr edukatën e parë. Shkollën fillore e kryen pranë Kolegjit të Françeskanëve (1929 – 1930, 1933 – 1934). Pas mbylljes së saj, klasën e pestë e kreu në shkollën pranë Dugajve të Reja. Në vitet 1934 – 1935 regjistrohet në Liceun shtetëror (është fjala për Gjimnazin e Shkodrës), ku vazhdoi deri në klasën e katërt të kursit të lartë. Nga fundi i vitit shkollor, pra, në mars të vitit 1942 u sëmure rëndë. Matura për të, tani, është vetëm një ëndërr e parealizuar. Vdiq më 28.05.1942.

Kur mosha duhej t’i fliste pranverës, Ndueja përjeton tragjizmin e jetës e tragjizmin e sëmundjes së tij... (Në vetvete poeti dhe prozatori i panjohur, tashmë i njohur, është personazh tragjik. Ky lloj përkimi gjen terren edhe në shënimet e tij, ku lexojmë: “Migjeni, ah, po, te shkrimet e tij shikoj aty këtu vetvehten e jetës teme”. (Lindi 11 vjet më vonë se Migjeni dhe vdiq 4 vjet më vonë se ai. Ndueja vdiq 20 vjeç, kurse Migjeni 27 vjeç. Të gjitha këto shënime flasin se midis tyre ka pasur vite bashkëkohësie, njohjeje, leximi e studimi.)

Pasioni dhe interesat për letërsinë kanë një fushë të gjerë. Ka lexuar me dëshirë dhe vëmendje Migjenin, Gj. Fishtën, Nd. Mjedjen, F. Nolin, N. Frashërin, D. Aligerin, V. Hygonë dhe Leopardin. Dhe ky spektër kulturor reflekton në krijimet e tij, si: në lexime origjinale (italisht e gjermanisht që i di shumë mirë) në përjetimet e rrëfimeve të personazheve, të shkrirjes së unit lirik, apo të skenave të ndryshme: epike a lirike qofshin ato, në zberthimin e ideve e argumentimin e tyre, ndriçime e këndvështrime të shkrimtarëve në raport me veprat dhe kohën e tyre, citime nga krijimet e autorëve, përqasja dhe elementet krahasuese, etj., etj.

Kodi poetik i krijuesit Ndue Pal Shllaku në marrëdhënie me kohën e realitetin shoqëror në të cilin jetoi, mendoj, që duhet vendosur në këto rrafshje: 1. Realiteti dhe problemet e tij. 2. Realiteti dhe shpirti i tij. (Këto poezi e copëza të saj janë faza e fundit e krijimtarisë së poetit. Raportet me vdekjen bëhen më të ngushta. Rrëfimi gjithashtu. Jeta ka trajtën e të jashtëzakonshmes e të tragjikes. Kënga e poetit, tashmë, më shumë është për vete, ka më shumë karakter autobiografik që konturohet me një rrëfim të dëshpëruar për një çast të caktuar të jetës. E vërteta e poezisë, vrulli dhe fuqia e poetit kanë gjendje dhe ritëm të shqetësuar. Dashuria është aq e zjarrtë, vullkanike sa edhe e dëshpëruar, në kacafytje, kësaj radhe të poetit me vetveten. Ai i kërkoi jetës t’i marrë sa më shumë jetë. Për të Koha është Jetë.

Në hapësirat e poezisë së krijuesit

Ndue Pal Shllaku lëviz hija. Poeti thotë: “Mërzija / dhe hija / me kangët e shpirtit t’im / Ushtojnë në mjerim”. (“Ushtima”, 14.07.1941.) Lëviz hana. Poeti thotë: “N’qetsin’ qiellore, o han’, shtrihesh / plot hire / n’mjerime t’njertzvet s’ngihesh e dëshire / Me t’pa, dikush sa s’ka mbarue.” (Hanës..., 11.11.1941.) Lëvizin: muzgu, mbramja, zemra, shpirti, retë që falen me diell, kujtimi, vetmia, andrra plot uzdajë, heshtja, dashuria e pafat, etj., në qerthullin e mjerimit. Në qoftë se te Migjeni trajtimi i kësaj teme lidhet edhe me qëndrimin e dukshëm të poetit, te Ndue Pal Shllaku trajtimi i kësaj teme e ka pikënisjen te shpirti i tij dhe hapësira poetike është sa vetë shpirti i tij. Këtu duhet ta kërkojmë realitetin shoqëror, i cili kornizohet dhe merr karakterin e intimitetit. Mbi bazën e kësaj metafore përcepton edhe motivin, ndërton strukturën e poezisë e sistemin figurativ të saj. Kjo vërehet: në imazhet e vendlindjes, në lirikën e peizazhit, si edhe në atë të dashurisë. Tek poezia “Mbramja”, dukuritë ‘arkaikë’ nuk e cënojnë aspak poetikën a frymëmarrjen e krijimit. E mbështetur në leksikon autentik të trevës së vet me të cilin operon përmes detajeve poetike, poeti idealizon fshatin, botën e tij, natyrën dhe njerëzit..., një pamje gjithë ngjyra romantike, realitet që është pjesë e fëmijërisë së tij. Dhe poeti e përcjell këtë poezi me këto fjalë: “Asht vështirë me e përshkrue bukurinë e mbrëmjes së fshatit t’im. Duhet me i ngjye shpesh herë gishtat në shllinë; duhet me fjetë në fierë me trup nënë krye në një zdatk me vathin e berrevet; duhet me i ndie e me u deshprue nga grahmat e fuqishme të malsorëvet punëtorë; për me mbujtë me e paraqitë mbrëmjen e jetën e hareshme të fshatit tim”. (gusht, 1941).

Ndue Pal Shllaku ishte një krijues jo shumë i përmendur, ndonëse botoi herë pas here poezi e proza në shtypin e kohës. Vdekja i shoi rininë e moshës. Arkivi me krijimtarinë letrare që la pas i ndrit rininë e moshës dhe i fal pavdekësinë e krijimit dhe të krijuesit.

Nga arkivi që kam në dorë, dhe nga fotografitë (të cilat janë të pakta), vetiu më vjen ndërmend një bisedë e bërë shumë vite më parë me regjisorin Lec Shllaku. Leci e kishte pasur Ndue, shok klase. Më bën këtë portretizim: “Ndueja gjithmonë më kujton Zherar Filipin tek “E kuqja dhe e zeza”. Tip sportiv, i veshur bukur (i kërputur), hollak, inteligjent, (inteligjenca shtrihet në të gjitha gjërat që e rrethonin e ku depërtonin sytë e tij shprehës), kishte buzë të trasha. Ndueja ishte formati i intelektualëve të asaj kohe. Paraqitja e bukur e intelektualit, që di e që mundet. Që don t’u thotë të tjerëve: “Kujdes kur të bisedoni me mua!”

Ndue Pal Shllaku është poet i drithërimës e i zemrës së drithëruar. Shpirtin ia fali poezisë. Poezia iu bë shpirt, jetë dhe dhimbje. Kështu foli në heshtje me “re dëshiri”. Dhe m’u kujtuan ca vargje të poetit polak Adam Asnyk: “Se çdo ëndërr, gëzim, gjithçka tretet, / edhe ëndjet, pasionet në botë ‘perëndojnë... por dhimbja veç mbetet”. (poezia: “Dëborë”) Bashkë me dhimbjen edhe magjia e një poeti të talentuar, që quhet: Ndue Pal Shllaku.

Xhahit Bushati



# NË SHKODËR, NJË MUZE I SHKËLQYER, NE SE KEMI ENDE NË VJENË

**Entela Resuli**

Arti shqiptar po krijon gjithnjë e më tepër ura komunikimi me skenën europiane, megjithë vështirësitë e një vendi të vogël.

Pak ditë më parë, në Vjenë të Austrisë u mbajt Festivali i parë i videoartit, ku disa artistë shqiptarë prezantuan përpara publikut austriak artin multimedial, e përmes tij, Shqipërinë e dikurshme dhe atë të sotme.

Annemarie Türk, kuratore e këtij eventi, njëherazi promotore e artit bashkëkohor dhe letërsisë shqipe, rrëfen për "Dita" përpjekjet e artistëve shqiptarë për t'u ekspozuar në skenën artistike perëndimore.

Türk është kuratore e pavarur dhe këshilltare nga Austria, që për më shumë se 20 vjet ka punuar në KulturKontakt, që ka mbështetur dhjetëra artistë shqiptarë, por së fundmi, është edhe në thujse çdo takim letrar në Panairin e Lajpcigut, në Gjermani, por edhe në një sërë takimesh letrare që mbahen në Austri e ku vitet e fundit janë ftuar disa autorë shqiptarë.

Ajo ndodhet këto ditë në Tiranë, bashkë me një grup prej 15 austriakësh, studentë dhe pedagogë, që kanë ardhur për të vizituar kryeqytetin në kuadër të një projekti kulturor.

**-Për dy netë, 13 videoartistë shqiptarë i prezantuan publikut austriak artin e tyre në "Déjeneur avec Marubi", që fokusohet tek Shqipëria e djeshme dhe e sotme. Emra si Anri Sala, Adrian Paci e artistë të tjerë, ekspozuan punët e tyre. A kishte interes nga publiku austriak?**

Interesi i publikut ishte me të vërtetë i lartë, kjo edhe sepse për të ishte diçka ekuivante, pasi videot shqiptare nuk kanë qenë asnjëherë të prezantuara në një format të tillë. Artistët shqiptarë (S. Agostini, D. Cina, E. Martini, V. Murataj, A. Paci, L. Qylafi, A. Ramaj, A. Sala, E. Teli, E. Zaloshnja, D. Zeneli, F. Zguro), patën mundësinë për t'u prezantuar në një nga muzeumet më të mira të artit bashkëkohor austriak. Publiku i pranishëm, pak dinte për artin bashkëkohor shqiptar, por reagimi dhe komentet ishin mjaft pozitivë.

Përveç punëve artistike, të pranishmit pëlqyen së tepërmi edhe diskutimet me artistët, pasi përmes tyre mësuam më tepër mbi Shqipërinë dhe morën informacione që nuk i kishim më parë.

**-Çfarë komunikonin videot artistike, për të kuptuar përmes kësaj pyetjeje edhe se nga se frymëzohen artistët bashkëkohorë shqiptarë?**

Gjatë atyre ditëve kishim disa sesione. Blloku i parë i videove fokusohet tek historia, ku publiku u njoh me periudhën e regjimit komunist. Ky ishte një prezantim për të kuptuar se çfarë ndodhi në Shqipëri gjatë asaj kohe, pasi vendi juaj ishte aq i izoluar sa askush në Europën perëndi-

more nuk mundi ta kuptonte se çfarë po ndodhte në të vërtetë aty. Dhe për të kuptuar të tashmen, duhet patjetër të njohësh edhe të shkuarën. Një sesion tjetër iu dedikua videove të artisteve femra, më pas patëm dy sesione për periudhën e tranzicionit dhe vitet e para që pasuan, pra rrugën e Shqipërisë drejt demokracisë. Blloku i fundit ishte për ditët e sotme, ku theksoheshin problemet sociale, ajo çfarë

e tyre, për t'i kapërcyer diktaturat dhe po ashtu për të treguar se si mund të zhvillohen identitetet e tyre europiane nga e para. Nuk është se ata po bëhen europianë tani, ata kanë qenë gjithnjë europianë por gjatë diktaturës kanë qenë të izoluar dhe Europa i harroi disi.

**-Duket sikur arti shqiptar po njihet gjithnjë e më tepër në Europën perëndimore. Sipas jush, është shtuar in-**



ndodh tani.

**-Ju njihni artistë dhe shkrimtarë nga i gjithë Ballkani. Nëse mund të bëjmë një krahasim midis krijuesve shqiptarë dhe atyre nga vendet fqinje, çfarë ngjashmëri dhe ndryshimesh vini re tek temat e trajtuara?**

Për fat të mirë, temat janë shumë të ndryshme mes artistëve ballkanas. Secili flet gjuhën e vet artistike dhe nuk ndjek vetëm trendet e artit europian. Ajo që vë re është që artistët e rinj që vijnë nga vendet e ndryshme të Ballkanit janë shumë të interesuar që të trajtojnë historinë përpara rënies së perdes së hekurt, për të kuptuar më mirë se çfarë ka ndodhur me vendet

**teresi i europianëve për Shqipërinë dhe artin tonë, apo artistët tanë po ia dalin t'i thyejnë kufijtë e të krijojnë më tepër ura komunikimi me skenën europiane?**

Artistët shqiptarë janë me të vërtetë shumë të zotë dhe me përvojë mjaftueshëm për të hedhur hapin dhe për t'u prezantuar në skenën europiane. Nga ana tjetër, duhet të them që skenat e artit të Europës perëndimore nuk janë dhe aq të hapura për artistët dhe veprat që vijnë nga Europa juglindore. Pra, jo aq të hapura. Ndoshta sepse ka padituri mbi gjallërinë dhe pasurinë e këtij arti. Ndoshta nuk është çështje paditurie, por më tepër, dembelizëm për të mos ardhur në Tiranë,

në Shkup apo në Sarajevë, dhe për të mos mësuar mbi artin që lind aty. Gjithsesi, kjo është shumë e ndryshme nga njëri vend në tjetrin. Për shembull, në vendet gjermano-folëse nuk është shumë e thjeshtë të botosh shkrimtarë shqiptarë në gjermanisht, ndryshe ndodh në Itali dhe Francë, ku letërsia shqipe mbërrin më tepër.

**-Në perceptimin tuaj, apo qoftë edhe nga çfarë keni diskutuar me artistët shqiptarë, si mendoni, sa e vështirë është të bësh art në Shqipëri?**

Padiskutim që nuk është e lehtë. Të jesh gjithnjë i stresuar dhe të përpiqesh për të mbijetuar duke ditur që veprat artistike nuk të mbajnë me bukë kjo është një sfidë jo e vogël. Ndaj, duhet treguar më shumë respekt ndaj artistëve dhe shkrimtarëve, në mënyrën se si ata e ndjekin karrierën dhe se si gjatë kësaj kohe angazhohen të merren me art. Edhe shtetet kanë një përgjegjësi mbi këtë çështje. Më duket që është e drejtë që të thuhet se shteti shqiptar nuk ka shumë fonde, të paktën jo sa vendet e Europës perëndimore, për t'i investuar ato para në art. Ndoshta s'ka aq para publike për artin, gjithsesi, unë nuk jam në gjendje ta them se sa para vihen në mbështetje të artit shqiptar, por mund të them me siguri që arti dhe kultura nuk mund t'i mbetet në dorë vetëm tregut të lirë.

Shteti dhe administrata publike duhet patjetër ta mbështesin artin. Gjithsesi, në Shqipëri shikoj herë pas here disa gjëra që vlejnë për t'u përgëzuar. Për shembull, në Shkodër është hapur një muze i shkëlqyer fotografie, që ne s'e kemi ende në Vjenë, ndonëse është diskutuar për krijimin e tij.

**-Le të fokusohemi më tepër tek letërsia. Ju jeni një ndër**





# ZVICRA, ZBULIMI I NJË KOMBI



Përgatitur nga Alfred Papuçiu

Kam lexuar, gjatë 32 viteve të jetës sime në Zvicër, që e kam përshkruar disa herë, shumë libra për arritjet e këtij vendi të vogël, me sipërfaqe 48 mijë km katrorë, që Rilindasit tanë e kanë menduar edhe për Shqipërinë tonë, por edhe për Kosovën martire. Por ju them të drejtën, se ky libër më bëri të mendoj edhe për Kombin tonë, që ka vlera dhe pasuri natyrore shumë më tepër se Zvicra, një bregdet të virgjër, në një pjesë të territorit të saj, dhe njerëz punëtorë dhe paqedashës. Kam pasur një simpati të veçantë për Nju Jorkun kur shkova tetë vite rresht në Kombet e Bashkuara dhe e ruaj atë vizion të bukur për të dhe njerëzit që banojnë aty, duke përfshirë dhe mijra bashkëkombas. Por për Zvicrën ku kam 32 vite që jetoj dhe punoj, kam një simpati tepër të veçantë. Parajsa egziston dhe dëshmi është ky vend i vogël. Prandaj u nisa për udhë dhe vendosa ta përkthej në shqip, këtë libër të përkryer të një gazetari të njohur zviceran.

Gazetari André Crettenand boton një libër të bukur për vendin e tij të vogël, por krenar. Pra së shpejti ai do dalë në shqip "Përsosmëria është e pranishme në

këtë vend".

Në librin e tij të vogël, nga numri i faqeve, me titull "Zvicra. Shpikja e një kombi", André Crettenand shkruan me plot elozhe për origjinën e tij. Ky ish gazetar i "L'Hebdo" dhe TSR, sot drejtor i marrëdhënieve ndërkombëtare, në Televizionin me prestigj TSR, Televizioni zviceran romandë, është autori i një "deshifrimi" të Konfederatës, në koleksionin «shpirti i popujve», në Botimet Nevicata, të drejtuar nga Richard Werly, korrespondent i përhershëm në Paris për "Le Temps". Çdo vëllim në këtë mënyrë kërkon të gjurmohet rrënjët kulturore dhe fetare të vendeve që nganjëherë humbën në mjegullat e globalizimit. Në një numër të vogël faqesh, André Crettenand tregon më tepër se 500 vite të historisë të Zvicrës.

Libri fillon me historinë e William Tell, mitit themelues të Zvicrës, dhe përfundon me homo alpinus, një popull i begatë, shumë gjuhësh dhe i përbërë nga shumë kultura, duke përfshirë edhe rreth 200 mijë shqiptarë, që ndjek në 2016 rrugën e tij drejt përsosjes. Gjatë përshkrimit të tij, André Crettenand lëkundet mes lavdërimit dhe kritikave rreth këtij shteti pothuajse tepër të begatshëm për të qenë i sigurtë, shumë pak i njohur për të qenë i vlefshëm dhe tepër i qetë dhe i lumtur për të ekzistuar. Midis vendeve historike të familjes frankofone, Zvicra zë një vend të veçantë: shumë gjuhësh, veçantia e trajektoreve së saj historike, origjinaliteti i modelit të saj politik dhe i konceptit të neutralitetit na e kujton këtë. Cokollata, orë, industri farmaceutike, high-tech... duke pasur parasysh aftësinë e saj dhe cilësinë e produkteve që eksporton, vetë Zvicra është kthyer në një markë. Ky vend me sipërfaqe modeste, i vendosur në zemër të Europës, ka përparuar, duke qëndruar jashtë Bashkimit Europian.

**-Një problem i madh që lidhet me depërtimin e letërsisë shqipe tek lexuesi perëndimor mbetet përkthimi i dobët. A është ky një problem vetëm me gjuhën shqipe, një gjuhë e vogël, apo është problem edhe për shtetet e tjera europiane?**

Ky është një problem ndoshta i të gjitha gjuhëve të vogla. Vendet gjermanofolëse nuk kanë përkthyes të mirëfilltë letrarë, megjithatë, më duhet të them që problem me përkthimin nuk kemi vetëm nga gjuha shqipe. Na ndodh t'i shohim probleme të tilla edhe tek letërsia armene, bullgare, etj. Pra, nuk është një problem vetëm shqiptar.

**-Ju e keni vizituar Tiranën disa herë, që nga viti 1996, kur ka qenë hera juaj e parë. Meqenëse këto ditë ndodheni këtu, ç'mund të na tregoni për kryeqytetin shqiptar, ju duket ndryshe nga viti i largët i '96-ës?**

Ndryshimi është me të vërtetë shumë i madh. Kam ardhur shpesh në Tiranë, ndoshta jo aq shpesh sa do të doja, por ndryshimet janë të jashtëzakonshme. Të duket sikur ndodhesh në një tjetër qytet. Megjithëse, disa vende kanë mbetur një-

**"Burimi i admirimit dhe xhelozisë"**


Dhe ende Zvicra ekziston. Formula sekrete e suksesit të saj? Mister! Por ka disa këngë. Liqenet e saj, malet e saj, neutralitetin e saj, sistemin e saj politik, qytetet, fshatrat, gjuhët e saj, nevojën e përsosjes dhe rendit, produktet e saj të eksportuara përtej kufijve që është e vështirë ti kapërcesh. Një Zvicër që arrin të përfitojë nga gjithçka, edhe kur është e kufizuar në vendin e saj, si një vend i vogël, e rrethuar nga shumë më të mëdhenj. "Zvicra nuk kishte nevojë për hapësirë, ajo tashmë kishte lartësi", shkruan autori. Nuk është pamja e jashtme që ka rëndësi, është e brendshmeja. Dhe brendësia e saj, sipas André Crettenand, janë burimet e pafundme. "Që i jep asaj aq shumë admirim se sa zhgënjimi xheloz".

André Crettenand druhet pak kur flet për vendin e tij kaq bukur, sidomos, për një ndjenjë krenarie që si një zviceran i mirë na mëson të përmbahemi. Por modestia e lexuesit është zhdukur nga ndjenja e saktësisë së një Zvicre, të treguar nga një prej bijve të saj. Një libër për ta kuptuar zviceranët, duke u kujtuar atyre që jetojnë atje, përse ndihen aq mirë dhe ata që kanë ikur pse duan të kthehen. Ashtu si autori i librit, tek i cili ne ndjejmë një nostalgji të ëmbël për këtë vend të privilegjuar që "nuk është zvarritur në fatkeqësitë e botës".

Këtu më poshtë po japim një pasazh të librit për lexuesit.

"Helvétia është një mit. Zvicra është një markë. Por si u krijua si vend, i populluar nga tetë milionë banorë, krenarë,

megjithë ndryshimet e tyre, me flamurin e tyre me Kryqin e Bardhë që njihet kudo? Dhe si arrin ajo të mbetet aq e begatë, duke qëndruar me vetmohim, jashtë Bashkimit Europian, që e rrethon? Që nga brigjet e liqenit Lemani deri tek fusha e Grütli, në lartësitë e Zvicrës qëndrore, deri tek luginat e Valesë, të rëpira deri



André Crettenand, "Zvicër. Shpikja e një kombi", Ed. Nevicata,

në kufinj të italofove të Tessin. Identiteti i Zvicrës kudo është ngritur në virtut. Por kujdes. Kjo lumturi e të qenit zviceran, shpesh e karikaturizuar nga ata që e vëzhgojnë nga jashtë me zili, gjithashtu meriton një diagnozë kërkuese».

**◀ promotoret e letërsisë bashkëkohore shqipe, e ju kemi parë vitet e fundit në thujse çdo takim letrar në panairin e Lajpcigut, apo gjatë, në Austri. A mjaftojnë këto promovime që letërsia shqipe të njihet më tepër në Europë?**

Pikë së pari, ekziston nevoja për ta bërë një gjë të tillë dhe kam bindjen që është e vlefshme që të realizohen këto aktivitete. Megjithëse, duhet shumë kohë që artistët dhe shkrimtarët shqiptarë të përfaqësohen me të vërtetë tek publiku evropian, nuk mund të pritët një sukses i menjëhershëm.

Është për t'u përgëzuar ajo që po bën Traduki, apo që e bënte në fillim edhe KulturKontakt. Mënyra që ka zgjedhur Traduki, duke mbështetur dhe përkrahur autorët, pra, është e shkëlqyer, mund të them që nuk mbetet alternativë tjetër përveç kësaj. E rëndësishme është që artistët shqiptarë po mbledhin gjithmonë e më tepër njerëz, në festivalet e filmave, nëpër ekspozita të ndryshme apo në panairin e njohur të librave. Është një proces i vazhdueshëm, i ngadaltë por që po vazhdon, ndaj, artistët këtu nuk duhet të dorëzohen, nevojitet shumë durim.

soj ose janë rinovuar pak. E rëndësishme është që të mos zhduket pjesa e vjetër e qytetit. Në ofitë se mbahet pjesa e vjetër, edhe me rritjen e qytetit, do ishte një gjë shumë e bukur.

**-Meqenëse jemi në këtë pikë të bisedës dhe meqenëse ju keni lidhje të forta me teatrin, a keni dëgjuar për debatin e shembjes së teatrit tonë kombëtar? Nëse po, çfarë mendoni ju, cila do të ishte zgjidhja më e mirë?**

Po, kam lexuar pak kohë më parë një artikull në Austri mbi këtë diskutim. Nuk e di ekzaktesisht se si është situata e këtij teatri, sa e rrënuar është godina e tij, sa e rëndësishme është në aspektin urban, sa e rëndësishme është në aspektin arkitekturor, e të tjera si këto. Por, mendoj se do të ishte një zgjidhje e mirë që ndërtesa e vjetër të rikonstruktosej, për të mbetur ashtu siç është, e më pas, të ndërtohet diku tjetër një teatër i ri. Mendoj që Tirana ka nevojë për teatro të tjerë. Do të ishte mirë që të kishte disa mjedise të tilla me profile të veçanta teatrore. Por unë, si austriake, nuk di ta them me vendosmëri nëse është vendim i duhur apo jo shembja e teatrit të vjetër, dhe nuk e di nëse pas këtij debati

fshihen çështje politike, ekonomike apo diçka tjetër.

**-Le ta mbyllim këtë intervistë me qëllimin e vizitës suaj në kryeqytetin shqiptar, ku shoqërohemi nga 10 studentë dhe 5 pedagogë të tjerë austriakë. Cili është qëllimi i këtij udhëtimit?**

Kjo është një vizitë e studentëve të menaxhimit kulturor të Universitetit të muzikës dhe arteve të Vjenës. Këta studentë dhe pedagogët e tyre vijnë për herë të parë në Shqipëri. Ata janë të interesuar për të mësuar më shumë për institutet e artit dhe institucionet kulturore të Tiranës. Do të takojmë këto ditë anëtarë të orkestrës simfonike të RTSH, do të njohim më tepër Tiranën e do të vizitojmë muzeumet e ndryshme, do të vizitojmë Universitetin e Arteve, do të vizitojmë qendrën kombëtare të kinematografisë, do të bëjmë një udhëtim të shkurtër në Durrës, ku do të na shoqërojë shkrimtari Arian Leka, do të vizitojmë disa galeri arti, etj. Tirana, përveç të tjerash, ka edhe një mot të ngrohtë e me shumë diell, që shpresojmë ta gjejmë këto ditë, ndryshe nga dita me shi kur mbërritëm.



# KODI ELITAR I NJË POETI VETËM SI I TILLË

Kështu fjala, si vlerë universale, në penën e Kaçajt po tentonte qartazi atë jetë që synojnë artistët seriozë, shumë më të plotë, më thelbësore, në identitetin e saj, “më intensive dhe mbi të gjitha më të përkryer për të qenë i pranishëm përtej pranisë që e thirrte nga jashtë.

Njerëz, kam një faj:

*Ju kam dashur*

është okelio e vëllimit poetik “Trishtimi i dritës” ndër më të arrirët e poetit, i botuar tetor 2018. Duke ndër zbrastësinë e jetës, boshin e dhimbshëm të saj, lehtësinë e papërballueshme të qenies në një kontekst socialpolitik totalisht absurd sa vetë njeriu nuk dinte ç’të bënte me jetën e vet, me kodin e saj vrapar brenda vetes, poeti synon të plotësohet në raport simetrik me emocionin estetik:

*“Piva, s’ di ku piva, por jam dehur, / dhe po ngrihem drejt qiellit si shpend, / gjoksin kam hapur, asgjë s’kam fshehur, / askend nuk shaj, asgjë s’më dhëmb”.*

Vargu klasik përmes rimës së alternuar AB/AB, në strofën katërshe, në harmoni me vizionin e një poezie që thotë shumë duke dëshmuar shkallën e lartë të moderacionit si thelb estetik-filozofik, dominohet nga muzikaliteti, ritmi dhe artikulimi funksional që sa vjen e rritet, si dimension i hapësirës së realitetit virtual që synon të rrokë poeti. Kështu përsëritja e verbit *piva*, “piva, por s’ di se ku piva”, tek vargu i parë, pasohet nga një artikullim në ngjitje i zanores *o* (por) “Dhe po ngrihem drejt qiellit si shpend”, tek vargu i dytë, krahasuar me *por* tek vargu i parë. Ndërsa tek vargu i tretë: “Gjoksin kam

hapur, asgjë s’kam fshehur”, rrok lartësinë maksimale, me një akustikë të realizuar në funksion të kumtit që përcjell një poet elitare si Dodë Kaçaj.

Dhe vetë zëri i gjuhës poetike, si zëri i Muzës, shpreh kumtin më të qartë estetik gjuhës si rezultante e vetë misionit të poetit si Krisht, Hamlet, apo Don Kishot:

*Piva, s’ di ç’kam pirë, / harrova emrin tim, harrova gjuhën time, / jam vetëm ajër, vetëm hapësirë, lamtumirë!... / Botën po nis nga fillimi!... (1990)*

Retiçensat, përsëritjet e verbit *piva*, që tingëllojnë: lëvizje, frymëmarrje, gjallëri, jetë, dimensionojnë kumtin poetik duke i dhënë fjalës përmasat e universit, si një mbretëri të llojit të vet për racën e poetëve të vërtetë. Si për të rimarrë forcë dhe energji të reja, si për të plotësuar muzën e tij që s’ njeh ngopje, ashtu si gratë shtatzëna në Greqinë antike, që rrotulloheshin rreth statujës së perëndive me shpresën se embrioni në trupin e tyre do të thithte diçka sublime nga shëmbëlltira e perëndive, Kaçaj i rikthehet jetës, vetvetes, dashurisë dhe lumturisë që i sjell në shpirt shëmbëlltira e të birit, Aurelit:

*Kryet hëne, / Fytyra diell, / Fjala – këngë, / Qeshja – qiell. (1990)*

Duke besuar tek njeriu, si besim tek jeta, Kaçaj sikur refuzon atë status hermetik, të pakuptimtë, vetvrasës të disa poetëve që të mbërthyer pas skemave të manierizmit modernist, kanë frikë të komunikojnë me jetën e gjallë, të mbetur kështu pre e dialogut me perënditë, si qëllim në vetvete. Poezia “Tim biri”, rreptësisht e kursyer në verbin e saj, përmes një

katërrrokëshi tërësisht emëror, vjen si një realizëm metaforik që rrok përkryerjen, po aq si një dëshmi e formës së çliruar nga diktati i përmbajtjes.

Anaforat në vargun e dytë dhe të tretë dhe aliteracioni : Qeshja – qiell, në vargun e katërt, të kujtojnë vetshelbimin kazanxakian, që rreket ta zbrastë poetin në burimin e pastër të njeriut, tej kohës dhe hapësirës, si “shqetësim për të njohur shpirtin e përgjithshëm të gjithçkaje, mi-trën njerëzore, ku poeti krijohet në dritë të plotë” (Niko Kazanxakis, “Heronjtë e mi”, fq. 105). Dhe në kërkim të plotësisht të mëtejshëm të vetvetes, poeti kërkon të prekë tokën, këtë pjesë të trinomit të shenjtë “Toka-deti-qielli”, apo “Atdheu i shpirtit të njeriut”, sipas Kamysë, ku derdhet si lëng plot jetë malli, dashuria, kujtimet për gjithçka, si raporti më domethënës i qenies, si identiteti që na ruan nga vetasgjësimi, apo shprishja jonë:

Është një fshat me male rrotull, / Bajzë i thonë – emër ilir, / Ngado që t’i bie botës, / Këtu kthehem me dëshirë (1986)

“Nëqoftëse ndonjë gjë është më e fortë se fati, është pikërisht guximi që e duron atë pa iu trembur syri”, shprehej Giebel. Dhe poeti Kaçaj guxon, guxon fort ta shohë veten drejtpërdrejt në sy. Vetë ritmi i tetërrrokëshit, i përdorur po me atë elegancë që e përdorte poeti i tij i zemrës, L.Poradeci, të kujton vallen e logut bajzjan, apo sfilatën popullore aty pranë Shpellës së Frashërit, mu në qendër të Bajzës, ku qe bërë traditë e mrekullueshme shpallja çdo buzëmbremjeje e mis bukurisë, nuses më të bukur të fshatit.

Ishte ky një tjetër ritëm brilant brenda asaj jete të thjeshtë, me poezinë e saj, plot iluzione dhe ëndërra për jetën, pavarësisht se asokohe termi miss s’kishte kurrfarë akustike në anonimatën e tij të plotë. Kështu vargu në poezinë “Bajza” sikur vallzon dhe vetë kjo sjellë konotacionin e një mendimi që serviret në formën aspak elitare të ritmit. Jo rastësisht Herderlin shprehej: “Çdo mendim vjen në formën e një ritmi”.


Falë kësaj, poezia e Kaçajt lëviz si tiktaku në “infini” në zemrën tonë, plot jetë dhe virtualitet të spikatur. Një kombinim i përkryer i tetërrrokëshit me pesërrrokëshin vjen në poezinë “Pa titull”, përmes rimës sa të puthur, po aq të alternuar, me një elegancë të rrallë, si sentenca më kruciale e një poeti bashkëkohor:

*Dhe fjeta. Si fjeta? / Ju s’ dini asgjë, / Shtrova veten / Dhe fjeta mbi të! (1990)*

E koduar mjeshtërisht në thelbin e vet estetik-filozofik, e kursyer gati në ekstrem në fonema dhe në fjalë si rrallë tjetër poezi në letërsinë bashkëkohore shqipe, poezia vjen si kumti më domethënës ekzistencial i qenies njerëzore.

Nuk ka stuhi të jetës që mund të sfi-dojë magjinë që struk qenia njerëzore në emër të mbijetesës, jo thjesht për të mbijetuar, por për t’u realizuar në vetvete. Në këtë vështrim kjo poezi është po aq thelbësore sa poezia me të njëjtin titull e Gëtes, ku guximi lexohet si vlerë thelbësore e dinjitetit njerëzor, kurse tek Kaçaj argumentohet ky guxim përmes një algjebrimi me dy të panjohura, reales dhe ireales, çka i jep aktit human të sfidës përmasat e mitit. Kjo poezi perlë, sprova

më e pakontestueshme e raportit estetik funksional brendi-formë në një krijesë artistike, ku secila prej tyre gjen vetveten tek partnerja e saj, sjell njëherësh nuanca të qarta kumti të njeriut – farë kazanxakian, që nuk pranon fitimin e së mirës si vlerë të epërme të qenies, por “sulmin për të fituar të mirën”, si një vlerë universale. Kjo, pa dyshim, është njëra nga poezitë më të goditura të vëllimit poetik “Trish-



timi i dritës”, që tregon njëherit dozat e fuqishme të modernitetit, si ndjeshmëri, si shije që nuk njeh kohë as hapësirë, po aq si njëri ndër krijimet më kuptimplote, që shënon shkallën e lartë të modernes, si vlerë e realizuar, po atë të modernizmit si sjellje e së resë, ndryshe si proces kreativ. Dhe, si për të pasuruar vizionin e tij sa estetik, sa human të besimit tek njeriu, tek dashuria si vitalitet, poeti shkrihet i tëri në fjalën e tij plot jetë.

*Një vegim, një vashë e bukur, / Zana e parë që pashë në botë, / Aq më dehu me një të puthur, / Si me pijen më të fortë. (1986)*

Në kufinj të këtij vargëzimi ndjejmë hapësirën që kërkon shpirti i lirë që e do aq shumë jetën, ndjejmë ritmin që i jep aq shumë gjallëri, frymëmarrje dhe impuls duke krijuar njëkohësisht po aq hapësira afrie me lexuesin që gjithsesi, përmes dashurisë si laitmotiv, kërkon të lehtësojë sa të jetë e mundur qenien njerëzore nga ferri brenda saj.

Këndvështrimi astigmatik i shikimit, dendësimi ekstrem i gjuhës, errësimi i shprehjes bazuar në përmbajtjen dhe në mjetet stilistike, koncentrimi i veçantë i së keqes, absolutizimi i imagjinatës janë ndër atributet më elokuede të poezisë moderne, që aq mjeshtërisht e gjejnë veten në poezinë e Kaçajt:

*Botë e bukur, / botë e lartë, / Dy të tretat ujë, / mbetja baltë! (1997)*

definon poeti. Tjetër poezi “pa kokë”, veçori kjo e poezisë moderne, brenda së cilës ndihen kategoritë “negative” të modernizmit, si: kotësia, pakuptimësia sipas shijes bodleriane, është edhe kjo poezi e Kaçajt:

*Këtë shekull / Jam i vdekur, / .. / Shekullin tjetër / Jam i fejtur / ... / Shekullin e tretë / Vij në jetë... (1996)*

Çka gjithsesi të kujton kredon kazanxakiane: “Zemra ime është një anije me vela të verdha, që nga bashi deri tek

kiçi, është e mbushur me Ulisë”.

Intriguese dhe jashtëzakonisht e arrirë për nga kumti dhe realizmi metaforik, në të cilin metafora shpaloet “e gjithëpushtetshme”, është poezia antologjike “Mos i kërkon kanibalët në xhunglat e Afrikës”. Vargu tepër elegant dhe eksplorues, vargëzimi që prodhon gjuhë, ku metafora, si ka braktisur ngjashmërinë mes sendit dhe figurës, ka kapë absoluten, ku plazmohet zhgënjimi total i poetit nga klithmat e entuziazmit modern:

*Mos i kërkon kanibalët në xhunglat e Afrikës, / tani kanë kravata, kostume dhe barqe të fryra / gjithë jetën i zë lemza e karrikes, / kanibalët kërkojini nëpër zyra... (1995)*

Universaliteti i mesazhit së bashku me vizionin postmodern të kreativitetit artistik përcjellin atë domethënie tejet të dhimbshme të metamorfozës së njeriut, plot aktualitet në “infini” të kanibalizmit modern, kur sot në botë numërohen 27 milion skllëvër modernë, produkt i trafikut të qenieve të gjalla në emër të industrisë më fitimprurëse të prostitucionit dhe të transplantëve, apo katër herë më shumë nga numri i skllëvërve të epokës së skllavopronarisë në Afrikën e largët.

Jetojmë, mjerisht, epokën e njeriut që, gjithsesi më tepër se veten, të kujton hijen e tij. “Vetëm tema e re, vetëm teknika e re nuk e bëjnë moderne, d.m.th të vlefshme një vepër letrare. E vlefshme dhe moderne njëherësh bëhet vepra letrare, kur në të përmbajtja dhe teknika e trajtimit të saj janë bërë një e re e papërsëritshme dhe e vlefshme për të gjitha kohërat” (Profesor Doktor Rexhep Qose, ABC, më 1.10.2005).

Këtë teknikë të re të vargëzimit, realizmin metaforik në përmasat e një vlerë estetike absolute dhe brendinë e re në përmasat e një domethënieje universale e gjëjmë tek poezia antologjike “Mos i kërkon kanibalët në xhunglat e Afrikës” të Kaçajt, ku lexohet qartë një këndvështrim totalisht skeptik i realitetit, larg etjeve për kult dogmash, idolash, apo idiolatish, doktrinash apo sistemesh qeverimi, pavarësisht nga modeli i tyre që i afrohen njerëzimit, çka rikonfirmon profilin elegant të një poeti me profil të kthjellët bashkëkohor: “Nuk e dija që liria nuk është shpërblim, as dekoratë që festohet me shampanjë...por angari dhe një garë e gjatë vrapimi, e vetmuar dhe raskapitëse”, do të shprehej Albert Kamy (“Rënia”, fq. 129). Duke ironizuar indirekt liliputët, levantinët, apo skllëvërit modernë të entuziazmit të po këtij brumi, që besojnë me një naivitet ekstrem përrallat me “Shqipërinë-Taivan”, e ngjashme me përrallën nga e kaluara: “Idetë tonë si e ardhmja e botës”, poeti tronditet thellë në vetvete përpara krimin që kultivon në mënyrë permanente shpërdorimi i lirisë, si akt vrapar i demokracisë së vërtetë:

*Në ç’shekull filloi ky shi, / dhe kur do të pushojë, o zot, / i hollë, i heshtur, i zi, si mort. (1997)*

Janë spunto të fuqishme, që dalin nga shpirti përballë një realiteti të errët, ogurzi, derivat i asaj klime mizerabël “lirie” (kur intelektual detyrohet t’ia besojë lirinë e vet kopukëve) që prodhoi 97-tën e kobshme,



# BLINI I GURIT T'LEKËS...

Hap pas hapi shkel mbi tokën e pjer-rët ndërsa një pikël djerse më rrëshket ngadalë nga lart, drejt thyerjes së brrylit. Deri kur mbërrin aty, as që e ndjej, madje në atë zheg më duket për një moment e ftohtë dhe e freskët.

Papritur më duket sikur nuk ka kufi ndërmjet lëkurës time dhe ajrit të ngrohtë të ngopur me aromë pylli: jo ajo e freskëta, por ajo ku bari dhe lulet e malit përzihen me rrezet e diellit; ajo që të mbështjell si një përqaftim i cili nuk mbaron.

Grupit i ika për disa hapa. Me ndërgjegjë të vrarë sepse grupit në mal nuk i iket, aq më pak aty ku shkel ujku. Por “m’u kishte bo boll”, – siç thuhet atje ku jam lindur.

Më kishte lodhur disi dialekti i tyre, i cili kërkon me shumë hapje goje se gjuha letrare shqipe, të cilën jam duke e mësuar dhe mundohem ta flas me shumë korrektesë. Ajo më kërkon më pak shtrëngime.

Ai dialekt më ngjan shumë me gjuhën e vendlindjes time dhe më zgjon kujtime, të cilave tani për tani nuk dëshiroj t’u jap hapësirë. Disa prej tyre nuk lenë vend për mendimet e rëndësishme të së tashmes.

Miku im shpeshherë më pyet me atë mënyrën e vet prej malësori, që mua me duket pak e vrazhdë, por që e njoh që nga fëmijëria: “Pse po munohesh me fol nryshe se qysh e ke dialektin?”

Ehh, ai sikur e di se ku po më dhemb. Pikërisht prej dialektit dhe pyetjeve u shkëputa nga grupi.

Toka nën këmbët e mia është e kuqe. Shoh drurë të thatë dhe të thyer të tular tur mes atyre me lartësi madhështore. Një trung rreth një metër e gjysëm i gjerë,



disi i kuq, si bakër i errët, edhe ai, i shtrirë përtokë. “Dallohët nga ngjyra. Është dru gështenje. Ky nuk kalbet” – më kishte shpjeguar një agronom, pjesë e grupit. “Bëhen gardhe të fortë me këtë lloj druri”.

Një zhapik kërcen mbi të. I afrohem por ai më ikën dhe fshihet mes gjetheve. Ulem në gjunjë dhe përkul kokën poshtë deri afër tokës për ta ndjekur me vështrim. Dheu ka aromë dielli.

Ja tek e dalloj tek lëviz i trembur. Barku ngjyrë bakri, kurri i gjelbër, kurse koka... Koka më kujton ujin që pashë kur u nisëm: i kaltërt. I kaltërt dhe kristal.

Grupi afrohet. Ndjej zërat e tyre të qeshur. Gezohem kur i degjoj edhe pse në ecje unë preferoj zërin e maleve mbi atë të njerëzve. Më ka marrë malli për ata zëra të ngjyrosur nga rrezet e diellit malësor dhe jo nga dhimbjet e dikujt, të cilit i ndalohet identifikimi me kombin.

Mundohem të kap çdo fjalë, çdo tingull, çdo zanore. I përsëris në kokën time, lëviz gjuhën në gojë, por nuk nxjerr zë.

Dëgjoj me vëmendje, dhe vërej se si një pjesë e imja çuditet. Çuditet si tingëllojnë aq ngjashëm me atje ku kam lindur. Vetëm se janë... zëra më të lirë. Po çfare kisha pritur? Një gjuhë të huaj?

Bën aq vapë sa hija e pyllit nuk mjafton më. E marr maloren me hapa të gjatë, shtrëngoj fort muskujt e barkut duke ecur dhe aty ku shkel, shkel mirë, pa frikë nga toka. Këtu nuk rrëshkas siç më ndodh shpeshherë në malet e Austrisë.

Dheu psherëtin nën prekjën time dhe një pluhur i kuq e mbush ajrin për disa sekonda.

Pas ecjes, kur dreka ka mbaruar, rrimë ulur bashkë dhe ata flasin e qeshin me ato zërat që tashmë më kanë hyrë në zemër. Miku im duket i heshtur dhe vetëm vështron me sy shqiponje.

Më jep çdo here ndjesinë që mund t’i drejtohem për çdo pyetje që kam. E lako trupin drejt tij dhe e pyes:

“Po qysh ka muni qe kaq shumë shqiptarë e bajnë një nryshim ndërmjet vetës edhe atyre si mue? Unë po nihem si me t’mit. Si me t’familjes. Po, mbas kufijve, edhe ju jeni shqiptarë ‘t’kuhiti’. Po s’gjej asnjë nryshim!”

Mora pra guxim të flas me gjuhën e nënës.

Me heshtje në sy por si gjithmonë me një urgjencë në zë, ai më përgjigjët: “Po nuk ka ndryshim! S’ka”.

– “Do t’thotë që ata shqiptarë që e bajnë nryshimin ndërmjet vetës edhe neve e bajnë edhe ndërmjet vetës edhe juve”.

– “Po. Ata kerkojnë që ne t’flasim në një mënyrë që ata me na kuptue neve”. Këtu zëri i tij bëhet më i butë dhe sytë i hapen paksa. “Edhe pse ti kurr’ ni malësor nuk e nin tue i than atij që me nryshue gjuhen e vet. I thot ‘Mfal, se s’tkuptova’, veq jo ma shumë”.

Shikimi i shkon të malet sikur e mendon një të dashur të papushtueshme dhe pas disa sekondave e afron dorën të njëra

anë e kokës, e bën një gjest sikur tregon që është i çmendur dhe thotë:

“Po ata edhe menojnë që na jem pak si t’krisur”. Edhe qesh. Unë bashkë më të.

Kujtoj një grua në plazh e cila, pasi i tregova që kam ardhur në Shqipëri, ndër të tjera, për të mësuar gjuhen letrare, më tha: “Ahh, shumë mirë sepse ju kosovaret e flisni shqipen shumë rëndë, nuk e flisni drejt”. Dhe më kishte dhënë një shembull: Dredhëzat u quakan mana toke dhe jo dredhëza.

Për një sekondë debatova me veten a t’i pergjigjem dhe t’i them që nuk ka “gjuhë të drejtë” dhe ne linguistët nuk bëjme vleresime të tilla, po vendosa të lë. Me ata që janë kundër një varianti të gjuhës nuk diskutohet për mënyrat si jeta shpreh shumësitë e saj.

I thashë: “Po te kisha ndjekur ndonjë shkollë në Prishtinë mendoj që do e flisja edhe shqipen letrare. Por unë këtë nuk e kam bërë. Prandaj kam ardhur në Shqipëri”.

Manatokat e egra lart në mal kishin një shije që nuk e kisha provuar kurrë. Ishin të vogla. Aq të vogla sa tre gishta bashkë i shtypnin duke i mbledhur.

Kur e pyeta mikun malësor: “A do luleshtrydhe?”, m’u hodh: “Luleshtrydhe?! Këto janë dredhëza! Eee, maj tash, masi s’po din me jau than emrin qysh e kan”.

Kur flet kështu zëri i tij është i rëndë por sytë e tij qeshin me dashamirësi. Kjo diskrepancë ndoshta i bënë jo-malësoret të mendojnë që malësoret janë pak të krisur.

Unë i ngreh pak krahët dhe i ha dredhëzat vetë.

Edhe pse për vajzen e rritur në Gjermani kjo mënyrë të foluri është disi e vrazhdë, vajza e lindur në Prishtinë sheh prapa vrazhdësisë dhe nihet si me t’vet.

**Jetë Zhitia**

kur kishim aq shumë nevojë për dashuri dhe solidaritet me

njëri-tjetrin. Kreshendoja kafkiane: “i hollë, i heshtur, i zi, si mort”, kullon krim dhe mister tepër të frikshëm. E madhërishtja, si vlerë shpirtërore e një populli, e kryqëzuar

në terrin që prodhonte subkoshienca e tij në hapësirat e një lirie, që po abuzonte skajshmërisht me vetveten u shndrrua në tragjikomiken e rrjedhës së tij absurde. Shqiptarët që kishin filluar të ngrinin krye për vlerat e qytetërimit të tyre të hershëm pellazgjik dhe iliro-evropian, shqiptarët që kishin dhuruar aq gjak për lirinë e të tjerëve në shekuj, kësaj radhe po kryqëzonin idiotërisht vetveten, sa si mister, sa si aventurë, prandaj poeti nuk ka gjumë:

*Nuk kam gjumë, sytë dot s’i mbylli, / në këtë natë të gjatë qershori! / Diku larg, pranë atij ylli / Vjen një flakë, një plagë krahrori (1997)*

Arti i Kaçajt vjen si një realitet estetik postmodern, ku lexohet qartë kriza që ka përfshirë, jo thjesht çdo modelim të qeverisjes dogmatike, por po aq vetë thelbin e qenies njerëzore, çka do të pasqyrohet doemos në të gjitha format e shprehjes së saj: etike, estetike, filozofike, politike, psikologjike e sociale, si një krizë universale mes thelbit dhe shfaqjes. *Pa merrni një shtëpi të Shoshit, / të parën që gjeni, / merrnie me çka brënda, kulm e themel, /*

*dhe futeni, bie fjala, në teatrin “Migjeni”, / dhe shihni ç’shaqje, ç’dramë që iu del! (1983)*

A nuk mund të shijohet kjo poezi si dramë, sa si poemë, sa si poezi dhe po aq si roman? Arti nuk është peshë, sasi, arti i vërtetë është cilësi, koncentrim maksimalisht i gjuhës, si eksplorim i ndjeshmërisë, si pasqyrim me gjuhën e sentimentit, apo të intelektit, me synim final përkryerjen në infinit. Në këtë vështrim poezia është vetë forma që motivon përmbajtjen në shpalosjen e saj, po aq sa vetë përmbajtja, idetë, justifikojnë formën si artikulum i shprehjes së thelbit poetik.

Shihni se si zanorja e në fjalët kyçe: merrni, gjeni, merreni, futeni dhe del artikulohe në rënie, si vetë lëvizja e krizës brenda thelbit filozofiko-estetik të mesazhit, si vetë kriza brenda universit të artit, si vetë kriza dhe dekreshendoja në vetë universin njerëzor, kur: “Tepër të mirë jemi/ mbi këtë botë ku na kanë lënë, o zot!”, definon poeti.

Kjo është drama më tragjikomike, më e llahtarshme që po përjeton njerëzimi, “kur të jesh i lumtur do të thotë të jesh fajtor”, thoshte nobelisti i viteve ’50-të, Albert Kamy.

Apo po t’i referohemi poezisë plot ndjesi të hollë “Natë me hënë”:

*S’ka gjë më të bukur, o nënë, / se të ecësh gjithë natën, një natë me hënë, / në*

*universin me yje, mbi fushën me vesë, / të bësh dashuri sa të shkrihesh me hënë...*

“Ngjitja nga ferri në purgator dhe nga purgatori në qiell – ja rruga e gjatë dhe e vështirë që të çon në shenjtëni – thoshte Kazanxaqis. Por poeti ynë, koshient për ferrin nga erdhëm, gjëmon:

*Ma hiq sysh atë zhele flamuri, / me një sorrë të balsamosur në mes, / të fal gjithë botën për një bukë gruri, / të ngopem njëherë, pastaj le të vdes (1987)*

po aq sa do të këshillojë për dramën që sjellin kultet e çdo lloji në çdo kohë dhe në çdo marrëdhënie të njeriut me qeverisjen e vet, po aq i dorëzohet deri në përkryerje dashurisë njerëzore si emblema më e shenjtë e jetës, prej së cilës ka ardhur njeriu dhe vetëm me të cilën njeriu do të shpëtojë nga ferri i vet.

Kulmin e vet ky mesazh e manifeston në poezinë plot sentiment, elokuencë dhe respekt deri në shenjtëri për njeriun e dashur të zemrës së tij, për shoqen e jetës, Florën, në poezinë “20 vjet me ty”: 20 vjet me ty buzë më buzë,

unë varg, ti muzë, / unë endje, ti ëndërr, / unë qiell, ti engjëll, / unë malli, ti pritja, / unë lodhja, ti ngritja, / unë vatra, ti zjarri / unë vdekja, ti varri.

Vargu tejet i kalkular, gjuha tepër lakonike, ritmi si lëkundja e djepit, zëri si mjalti i jetës, fjala si zëri i shpirtit, kumti si dhurata e perëndisë, vetdehja si vullkan

dashurie sjellin mes nesh mesazhin më të lumtur në botë

“Dashuria mes dy njerëzve është e përsosur kur njeriu i thërret tjetrit: O Unë!... Vetëm dashuria, siç thoshte Kazanxaqis, do ta shpëtojë njerëzimin”. Prandaj poeti definon mrekullisht: “Edhe 200 vjet me ty / Sy më sy!” (1997)

Kush “guxon” ta lexojë shpirtin e tij – ai në jetë të jetëve do të jetë “i dënuar” të përkulet me respekt para fjalës së tij brilante.

Dhe sikur këto të mos mjaftonin, eseja “Letër”, në fund të këtij vëllimi, një ese elegante e vëllait të poetit, Tonin Kaçajt, nën kujdesin e të cilit erdhi në jetë ky botim, vjen si një dekret sui generis, apo “ligjërim”i një komunikimit të llojit të vet, mes dy poetëve, mjeshtër të fjalës, ndryshe si kodi më i kthjelltë i përjetësisë së fjalës si vlerë universale: “Nanat e paskanë ditë mirë kur thanë ”çdo njeri ka në qiell yllin e vet, e kur ai yll bie, njeriu vdes”, por diçka na e mbajtën të mshehtë...Kur na thanë “vdes njeriu”, nuk na thanë se njeriu jo thjesht vdes, por në të vërtetë, zë vendin e yllit të tij të vdekun, në qiell...Pikërisht kështu iku fizikisht nga jeta për të mbetur si një yll në universin e letrave shqipe, kodi elitari i të cilit ishte vetëm si i tillë, ky ishte Dodë Kaçaj!?!

**Kadri Ujkaj  
kritik letrar**



# VJOLLCA E DUKAGJINIT

Jam rrite tue e adhurie si lule, mbimja e saj ka kenë një nga dhuratat e natyrës malsore, sa shendin e binte kjo lule mbas dimnave të gjatë e të randë. Nuk kishte ma knaqsi se me e pa ngjyrën e çiltë të saj, kur petalet i qeshnin në shpërthim mbi tokën ku sapo ish dejë bora (shkri bora). E qeshun lulje si me kenë qeshje njeri të lumtun, patravajë. Shpesh ma kujtojnë qeshjen e kesaj lulje do ftyra njerezish këtu në Amerikë ku jetoj, disa njerez që e di se i kanë qitë të tana vendave, e s'kanë farë halli në ftyre të Tokës. Malsorët e kanë njoftë si lule me kohë, njaq sa prej ngjyres së saj ia kanë dhënë edhe emnin njenës nga te shtatë ngjyrat, asaj që në gjuhën e standartizueme i thonë "E Verdha" - malsoret i thone "E Lultë /-a". E Lultë si kjo Lule që qeshet me tanë optimizmin e ngjyrës së vet...ka ardhë pranvera...gëzoni. Lulja quhet "Vjollca e Dukagjinit."

Pse e ka bash këtë emën!?

## Vjollca e Dukagjinit - E Lulta...

E kisha vra mendjen për shume kohë pse e kishte atë emën kjo lule e vendlindjes teme, pa mujtë me gjetë një shpjegim... Shpjegim që e gjeta ma vonë në Bibliotekën "Marin Barleti" të qytetit të Shkodres, ku lexova një artikull nga studiuesi Rrok Zojzi, ku kishte shkjarue lidhun me këtë lule simbol të Dukagjinit. Nji ar-



tikull botue ma se pari në revisten "Hylli i Drites" numri 7 i muezit korrik të vjetës 1922, faqja 331, artikull i plotesuem ma vone nga i njajti autor dhe i ribotuem në revisten "LEKA", numri 6 i muezit Qershor te vjetes 1937, faqja 261...artikull i titulluem "Rreth rrmimeve Botanike në Shqipnise e Verit", ku mes tjerash Rrok Zojzi shkruente:

-“Në vjetin 1913 kur Shqipnija kishte fitue të drejten politike me dalë shtet në vedi, me një herë u formue një komision për caktimin e kufijve të Shqipnisë. Ministrinë e luftës së Austro-Hungarisë në ket komision e përfaqsonte Obert A. Mietzl. Akademie der TË issenschafter pranë Ministrisë s’Arsimit në Vjenë, qi këqyrte me shfrytze ç’do rasë, ndermjetoj në Komandë që me komisionin e kufijve të bashkohen edhe një botanist e një zoolog.



Ignaz Dörfler

Si botanist u shenjue rishtas Dorfleri, Komisioni me 3 Maj 1914 la Shkodren tuj u nisë gjatë luginës së Cemit në Vermosh ku u ndal pse çashtja lypte ma tepër studim. Në ketë rasë Dorfleri shetiti bjeshkët e Shqipnisë së verit e tuj ba qender në Vermosh

eksploroj bjeshkët e Kelmendit e Bjeshkët e Namuna.

Ma vonë muezjt me shetitë grupin e Jeseres (Jezercës), e u ngjit në majen ma të nalten 2700 m. U suell kah Jugu i Gucisë e i Plavës e kerkoj ku rrallë kish shkelë kamba e njeriut. Me plasjen e luftës botnore, 26 Korrik 1914 la rrmimet e nepër Qafë të Prushit duel në Spas-Flet-Gomsiqe-Zadrimë e Shengjin. Vizare bimësh të panjehuna mblodh në ket udhtim qi i duel shum ma interesant se e kishte mendue. Studimin e bani me Dr. August Eden von Hayek, i cilli ma vonë botoj edhe një liber të zbukuruem edhe me ftyra. Në këtë të sjellun ju shtuene florës së përgjithshme edhe 9 rode të reja shqiptare.

Por ma interesante asht vjollca qi u pagzue me emnin e fatosit Shqiptar Viola Skanderbegi, e cilla u gjet nder rrethet e Vermoshit dhe dallohet prej të tjerave ne për lulen me gjeth të mdhaj.



Viola Skanderbegi

Mjaft e bukur asht edhe një lloj tjetër vjollcet, e cilla pse gjindet vetem në Dukagjin hyni në botanikë me emnin Viola Dukaginica, çilë do lule si vjola mezatare me pesë gjeth krejt të verdhë.”

“VIOLA DUKAGINICA” ose “VIOLA DUCAGINICA”

Lulja e Bjeshkeve të mia...Bash lulja që isha rritë tue e adhurie çdo stine, paska



Viola Dukaginica

qenë bimë endemike, prandaj studiuesi I kujdesshem austriak me sakesine që e karakterizon ate komb, e kishte klasifikue në tipologji si “Vjollca e Dukagjinit”... Kujtoj veten se si mora frymë thellë kur e lexova këtë fakt...mora fryme thelle...

sepe e provova ate ndjesine qe ndjen njeriu kur provon se një intuitë e paska orientue saktë. Qysh ne fmini e kisha pase një bindje qe kjo lule kishte lidhje të posaçme me ne, Malsoret. Pse e tek, nuk dijshe me e shpjegue, por e ndiejsha... nga ato ndjesite qe njeri i ndien e nuk i shpjegon dot. E qe, ku ishte shpjegimi, duhej me ardhë austriaku nga ana e anes e me ma diftue se kjo ishte Lulja e Malsisë për të cilën kendojne me aq forcë kangtarët malsorë si Fatmire Breçani, Gezim Nika apo Nikollë Niprelaj... -“Po në shenimin e Rrok Zojzit shkruhet se gjindet vetem në Dukagjin?” - mundet me ndërhy ndonji skeptik idhnak, ndonji nga ata skeptiket jo të pakte që torturojnë perditë gigabajtet e rrjeteteve sociale. Për ta kemi një lajm...Dukagjini asht ma i madh sesa e kujtojnë ata...

-“Percaktoje Dukagjinin”, – munden me skeptikue prapë ata...

-Sigurisht qe kemi me e percaktue... Dukagjini ne thelb ashte vetë Gegnia. Sa i madh asht Dukagjini? Dukagjini asht disa here ma i madh se krahina mbi Shkoder qe sot quhet Dukagjin. Dukagjini dikur shtrihej edhe në Mirdite, perfshinte Has, Lumë, Malsi të Gjakoves si dhe tokat shqiptare në Kosove që ende sot quhen Rrafshi i Dukagjinit.

-“Mirdita Dukagjin?” – munden me skeptikue prape...

Ne vepren e tij “L’Albanie et l’invasion turque au XVe siècle.” (Arbëria dhe pushtimi turk në shekullin XV, Louvain - 1937), doktori i shkencave historike Athanas Gegaj na shkruen:

-“Familja e Kapidanit të Mirdites, sipas traditës së familjes e merr origjinën nga Pal Dukagjini, i princave Dukagjin, të cilet zotnonin ndërmyet bregut të majtë të Drinit dhe burimit te Fanit, e perreth Leshit, kryeqyteti i tyne. Emni Dukagjin shfaqet per here te pare ne vjeten 1281, kur perendimoret emnuem Dukë Gjin Tanushin, (Gjin Tanushi), “Duka Gjin” = Dukagjin. Por për këtë familje flitet që nga shekulli i parë. Ata zotenuen mbi një pjese të madhe të Mirdites, Gashin, Krasniqen, Pejen e Gjakovën, ku në shekullin e XV sundonte Pal Dukagjini e mbas tij Leka, nga dega e parë. Dega e dyte zotnonte mbi Leshin, Zadrimen e poshtme, Puken, Seliten, Bubën, (Zhubën) e Fanin. Kryeqytet ishte Leshi, dorezue venedikasve me 1393. Origjina e Gjonmarkajve të Mirdites vjen nga Nikolla i Pare i Dukagjinit, bir i Gjergjit i dhe vllau i Tanushit IV, ky i fundit permendet me 1429 ne arkiivat e Venedikut.”

Këto të dhana që na jep Athanas Gegaj perputhen plotesisht me mbamendjen popullore të ruejtun nga krahinat e Malsise. Në vetëdijen e tana anëve si Shala, Shoshi, Shllaku, Nikajt, Merturi (qe asht Berishe), Berisha përgjatë brigjeve të Drinit, Gashi e Krasniqja, Thaçi, Kabashi, Morina, (Morinë asht trajta e ndrrueme e Marin), Hasi dhe Luma, Sopi, në të tanë anet e fiset ne kalkun e qenësisë se tyne mbajne mbrenda ate perkatesi, Dukagjinin. Dukagjinin që di-

kur kje principate me male e fusha, me kryeqender Pejen legjendare, qytetin e magjishem mes Alpesh. Mbamendje qe njeh Dukagjinët zoten te Mirdites e ma gjanë, mjafton me kujtue ketu kangen e dalun në kohen e Prenge pashes:

“Dervish Pasha hype ne kshjtelle / ky Preng Pasha shka po ka / shka po ka qi s’flet me mue / i kane ar dhe letrat per me shkue / Dervish Pashe ti ke gabue / Qi ke nise vapor per mue / Qi ke nise vapor Misiri / tE po m’pritka n’gryke t’Shengjinit / Se me thone Pasha i Dukagjinit!”

Ne revisten “Hylli i Drites” XIII, korrik 1937, lidhun me kete teme njaft interesante, mes tjerash në numri 7 dhe 8, shkruhet:

- “Mirdita, (Orosh, Spac e Kushni), simbas gojedhanes e kane origjinen nga se asht e rrjedhun prej fisit Marin, (Morine), kta tre barqe emnohen gjithmone tre barqet e fisit se rrjedhin nga njaj fisi, e kndej njani-tjetrin e trrasin vlla. Kete vllazni nuk e kane as vllazni shoqinjet, as vllazni politiket as perkundra muhamedanevet, por n’diftim te një fillese e t’një burimi, vllazni qe rrjedhe prej një gjaku. Ket vllazni e rrefejne se e kane dhe me Shale e Shosh. Prej ksaj vllaznije qe rrefejne se kane Oroshi, Spaci, e Kushnini, asnji n’tre, as me shoshojne, as me Gjomarkaj, nuk kane marre as dhane gra ne kohe tona se thone : -“Vllau mik nuk ka si bahet.”. E mandej thone:

-“Oroshi ka 12 barqe e fise të dyta, e ma i pari n’kto asht fisi Markolaj, e t’kti fisi jane Gjomarkajt e Kreu me shpijat e veta. E ma poshte: sa per çashtjen e Dukagjinvet na e dime se kjo Derë kje prej fisit shyptar, e jo t’vogel: e kjo qi sundoi gadi t’tretën e Shqypnise per dyqind e sa vjet.”

Nje tjetër rrmim historik qe e kam verejte, mirditoret jane pasardhesit e fisit te njoftun te Pirusteve, pak kush asht marre me emnin e ketij fisi si duhet me u marre, nga vjen e çka do me thane, “Piruste” asht fjalë shqipe arkaike, domethane “Prush”, pse Pirustet njiheshin si xehetarë (metalurgë), të famshem, shkrinin bakrin dhe kuptohet kjo u jepte perparesi ne Epoken e Bakrit. Natyrshem ata si zoten te metalurgjise ia dolen me sundue zonen dhe me e shtri dominimin e vet ne tana anet...emni i tyne ishte kudo ne ato vise, shkoi deri matane Hasit në Qafen e Prushit, qe ne shqipen arkaike domethanë “Qafa e Pirusteve” pse Prush vjen nga fjala “Pirust”...

Tane keto te dhana dishmojne se Dukagjini asht shume here ma i gjane gjeografikisht sesa e percaktojne sot, ne krahinen malsore qe percaktohet me ate emen. Vetedija etnike, etno-psikologjia, gjeografia shpirtnore e dishmon ate gja, kjartazi pse kane kaq shume ngjashmeni ne gjuhe, doke e zakone, ngjashmeni qe nuk u zbehen as mbas pushtimit Osman kur një pjese e kesaj principate dukagjinase nderroi fene duke u kthye ne myslimane. Ne thelb malsoret e Malsise se Gjakoves dhe banoret e Rrafshit te Dukagjinit ruejten te njajtat doke e zakone qe kishin mujte me mbarte e me ruejte nder shekujt e gjate e te rande te pushtimeve barbare...

Përkthyer nga Ilir Seci



# ENIGMA E JETËS NË PLANETIN TONË



Nga Lekë Imeraj

Njeriu shkoi në hënë pa e ditur se nga u nis. Ndoshta mund të bëhet dhe vizitor i planeteve të tjerë pa e ditur këtë gjë.

Legjione të tëra astrologësh, astronomësh, gjeologësh, kimistësh, biologësh, antropologësh dhe shumë të tjerë vazhdojnë me shekuj të merren me menyren e formimit të planetit tonë, tokë, dhe mbi të gjitha, me lindjen e jetës në këtë planet. Pavarësisht nga kerkimet, për nga rezultati, të duket sikur kanë filluar vetëm dje. Mund të mendohet se nuk kanë shkuar më larg se grekët e lashtë. Nëse njeriu, është një formë tipike e jetës në tokë apo, një zhvillim ekzotik, siç duket do tu mbetet brezave pasardhës që ta sqarojnë.

Problemi është se, për aq kohë sa nuk do të mund të mësohet prejardhja e njeriut në tokë, ai nuk do të mund të studjohet dhe të njihet se kush është.

Dikush e mendoi se jeta lindi spontanisht, nga uji ose balta. U paraqitën edhe prova për ta argumentuar këtë teori. Nëse

do të lemë diku „mbeturina“ për një kohë të gjatë, aty do të krijohen gjallesa, si krimba, minjë kanalesh etj.

Shpikja e mikroskopit, në vitin 1590, e varrosi këtë spekulim. Louis Pasteur (1822-1895), në vitin 1864 nguli guzhden e fundit në arkivolin e kësaj teorie. Jeta nuk lind as nga balta dhe as nga plehrat.

Që të mund të vertetohet origjina e jetës në tokë, nder të tjera, duhen vertetuar dy gjera, nga më të rëndësishmet: E para, si ishte toka pas krijimit të saj, dhe e dyta, si lindi faza e parë e jetës në tokën e vdekur, kush është gurthemeli i saj? Fjala është për lindjen e aminoacideve, pjesve përbërse të albuminës dhe format primitive të jetës.

Ajo që ne dim sot është se toka u krijua para 4.6 miliard vjetësh, nga një masë e pafundme gurësh dhe dheu dhe që filloi të rrotullohet rreth diellit.

Gjurmët e parat e organizmave në tokë mendohet të jen mikroorganizmat e gurëzuara, të cilat mendohet të ken jetuar para 3.5 deri 3.8 miliard vjetësh. Mendohet se ishin banorët e parë të planetit tokë, të ardhur nga një jetë e përbashkët universale. Kjo është një ide.

Ideja tjetër është se, para miliarda vjetësh, planeti tokë i pajetë, u bombardua nga kometat, të cilat krahas dëmeve të mëdha, suallën edhe jetën në tokë.

Një gjë mendohet se dihet shumë mirë se, në planetin tonë pa jetë, nuk ka pasur oksigjen. Oksigjenin këtu e krijuan gjallesat e para të tokës. Nëse është kështu, atherë nuk qendron teoria e lidhjes së tokës me planetet e tjerë.

Që nga viti 1920 mendohet se, atmosfera e tokës, u krijua nga metani dhe amonjaku. Sipas biologëve, një perzjerje e tillë, krijoi kushtet për krijimin e aminoacideve.

Në vitin 1953, studenti Stanley Miller, në mbikqyrjen e profesorit të tij, Harold Urey, eksperimentoi një mundësi të tillë në kushte laboratorike dhe rezultati ishte pozitiv. Në një kazan të madh, futi material nga atmosfera e vjetër e tokës dhe në një tjetër ujë. I vuri të dya nën veprimin

e rrymave elektrike që shkaktoni blice (shkreptima) dhe receta e mundësisë së krijimit të atmosferës së tokës u vërtetua. Të njejtin eksperiment kishte bërë edhe Charls Darëin (1809-1882), në vitin 1871 por, vetëm në kokën e tij. Ai imagjinoi një pellg të madh me ujë të ngrohtë, plot me amone dhe kripëra fosforike, dritë nxehtësi dhe elektricitet, si gurthemeli të krijimit të jetës. Për krijimin e jetës, duhet një atmosferë mbyhtëse, mjaft ujë dhe shkreptima.

Jetëkerkuesit e tokës, akoma nuk janë të bindur, nëse në atmosferën lashtë të tokës, kishte sasira të mjaftueshme amonjaku dhe metani, sa të mund të mjaftonin për krijimin e jetës në tokën pa jetë.

Nëse atmosfera ishte me të vërtetë ashtu, siç e mendonin Urey dhe Miller, atherë lind pyetja tjetër: Nga erdhi uji?

Jeta, as që mund të mendohet të krijohet, dhe as të jetohet pa ujë. Prejardhja e ujit në tokë, deri më sot, është absolutisht e paqart.

Mendohet se burimet e ujit në tokë janë, kristalet e akullta dhe asteroidet e rëna nga stratosfera. Të tjerë mendojnë se toka është përbërë nga disa miniplanete, disa nga të cilët suallën ujë me vehte.

Në vitin 1969, në Murchison të Australisë, ra një meteorit. U vërtetua se ai përmbante sasira të mëdha aminoacidesh, tamam si ato që njerzit mundoheshin ti prodhonin në tokë. Kjo e përforcoi shumë mendimin se jeta në tokë ka ardhur nga planetet e tjerë. Por, megjithatë, gjithëçka mbeti e dyshimtë.

Edhe nëse pranohet fakti se aminoacidet erdhën nga planetet e tjerë, ato nuk janë jetë. Të paktën nëse do të kishim diçka në formën e bakterieve, edhe mund të pranohet jeta në planetin tonë si dhuratë e kozmosit.

Të tjerë e mendojnë jetën si rezultat i evolucionit kimik, derdhja e llavës së vullkaneve në ujë, etj.

Një teori tjetër, disi e preferuar, mundohet të argumentojë se, në planetin tokë, para se të krijoheshin gjallesat e sotme, kanë jetuar të tjera, krejt të ndryshme nga këto të sotmet. Mendohet se ato gjallesa,

falë aftësisë së tyre për tu nëndhesuar, u zhdukën nga sipërfaqja e tokës para 3.9 miliard vjetësh. Mendohet se shkak ka qënë një bombardim masiv i tokës nga kozmosi, bombardim që e sterilizoi tokën nga jeta. Të paktën në planetin Hënë, është vërtetuar një gjë e tillë.

Ndoshta jeta në tokë ka ardhur nga planeti Mars. Kjo mbetet për tu vërtetuar kur njerzimi të mund të fusë në laboratorët e vet kerkimor copëza nga trupi i Marsit. “Planeti i kuq“, me një sipërfaqe stabile dhe një klimë relativisht të ftohtë, mundet ti ketë ruajtur gjurmët e jetës para miliarda vjetësh.

Në vitin 1996, pati një sensasion të madh. Në Antarktidë, u gjet një gur i pazakontë i cili u emertua ALH84001. Pas hulumtimeve që ju bënë, u arrit në konkluzionin se ai vinte nga planeti Mars. Aty u vërtetuan gjurmët gjallesash të vogëla. Pa zgatur shumë, sensasioni u kthye në zhgënjim. Guri ishte toksor dhe jo nderplanetor. Megjithatë, shpresat nga planeti Mars, duke e menduar atë si burim dhe arkiv të jetës, janë të mëdha.

Ndoshta nuk është për tu injoruar as teoria tjetër se jeta ka ekzistuar para krijimit të planeteve. Kjo mbështetet në hipotezën e panspermës, sporet e fshehura tek bakteriet të cilat qarkullojnë në stratosferë, në asteroidët dhe kashtat e qumështit.

Nga të gjitha këto, hipoteza më e pranueshme mbetet ajo, e prejardhjes së jetës nga stratosfera, me anë të gurve apo materialeve të tjera „bombarduese“ të tokës.

Sistemi diellor përbëhet nga një numur i pafund asteroidësh dhe minibotësh, me përberje nga më të ndryshmet fiziko-kimike dhe temperaturash. Në këto minibotë, është normal të mendohet se, kushtet për zhvillimin e bakterieve të ndryshme, të jenë shumë më të pershtatshme se kudo tjetër.

Pavarësisht nga të gjitha këto teza dhe hipoteza, sqarimi i prejardhjes së jetës në tokë, do tu mbetet brezave të arthshëm që ta sqarojnë.

# Ahmet Osja, shembull përkushtimi në shërbim të vendit

Të nderuar të pranishëm!  
I nderuar profesor Ahmeti!  
Zonja e zotërinj!

Sot nuk jemi mbledhur thjeshte për t'u paraqitë një libër, që dhe kjo ka rëndësinë e vet, por jemi mbledhur për të paraqitur këtë libër, monografi, me titull "Profesor Ahmet OSJA- Mjeshtër i MADH, 80 vite jete, pune, krijimtari"

Profesor Ahmeti, nuk ka qënë e lehtë të vish në 80 vjetorin e lindjes! Për të aritur në këtë datëlindje, të është dashur

një rugëtim i gjatë me shumë punë, shumë përkushtim, shumë përballime të vështirësive objektive e subjektive, shume ngjitje e zbritje shpateve të Alpeve shqiptare në Dukagjin, kalimin e shumë përrrenjve, lumenjve, oqeanëve e detyrave, të cilat falë dhuntive të tua, gjithnjë i sfidove, asnjëherë nuk u dorëzove, gjithnjë dole fitimtar dhe sot të kemi në mesin nesh, me plot krenari për jetën e veprën tende, me plot vitalitet, shembull për sot e për nesër për të rinjtë e të rejtat.

Si u njoha me familjen Osja?

Me familjen Osja jam njohur në vjeshtën e vitit 1970. Në këtë kohë, në Kelmend isha në detyrën e komandantit të batalionit sulmues (bs), me qendër në fshatin Vukël, ku buron lumi i Cemit.

Në atë kohë, fshatrat Vukel, Nikç e Kozhnje formonin kooperativën bujqësore, e pagëzuar kooperativa bujqësore e Vuklit, qendra e së cilës ishte në fshatin Vukel.

Në këtë kohë, kryetar cooperative ishte Ahmet Mema dhe personi i dytë me një



autoritet të padiskutueshëm, absolut ishte Shaqir Osja, shefi i financës së kooperativës bujqësore.

Shaqiri nuk ishte nga natyra autoritar, madje ishte shumë i qetë, shumë i komunikueshëm me të gjithë banoret e kësaj cooperative pa dallim niveli kulturor apo pozicioni.

Autoriteti i tij vinte nga ndershmëria e tij, Shaqiri ishte profesionalisht shumë i aftë, financier shumë korrekt dhe i ndershëm. Mbi tavolinën e punës, nën xham kishte vendosur një copë gazete, në të cilën shkruhej “Pse firmos shoku financier?”

Sa herë kisha shqetësime apo mërzë ngjitesha lart, rreth 15 minuta rruge dhe takoja Shaqirin. Unë pija nga një gote raki, por ai, nuk pinte. Bisedonim e bisedonim në pafundësi, e donim shumë njeritjetrin. Nga Shaqiri frymëzohesha për të kaluar vështirësitë, për të kaluar mërzinë.

Kështu u njoha me familjen Osja, të cilët ishin me origjinë nga Reçi, dhe banonin në Velipoje, në lagjen e Luarzit.

Ai, më fliste shpesh për të vël-lain e tij, Ahmetin, i cili në atë kohë ishte me pune në kooperativën bujqësore të krahinës së Shalës dhe shumë i dhënë pas punës, pas punës shkencore në bujqësi.

Nga rrëfimi i Shaqirit, që në atë kohë, në distancë pata krijuar një respekt në vetevete për Ahmetin, agronom në Shalë. Dhe më pas pata dëgjuar për Ahmetin, për punën e tij krijuese e shkencore në Stacionin e Misrit, në Ministrinë e Bujqësisë, kur u emërua në detyrën e vështirë të Ministrit, por direkt e njoha pas vitit 2003 nëpërmjet mikut tim, Luigj Shyti, të cilët ishin e janë shumë miq.



poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi

## SHTOJZOVALLET E DUKAGJINIT

Kush mallet shqiptare me kambë nuk i ka shkelë,  
ka mangësi në formimin e tij kulturor me vlerë.  
Sado në foto e libra mundesh me pa e me lexue,  
Emocionet që t'formohen, n'kontakt me natyrën,  
Gjithë kohën që jeton nuk mundesh me i harrue.  
Si shndritë drita e hanës në male të Dukagjinit,  
me tu dukë se n'botë ka ardhë një tjetër soj diellit.  
Si këndon heshtja ne luginën e lumit të Shalës,  
Të duket vetja i vogël si me qenë në gjë t'nanës.  
Ishte ditë pushimi, nade në lum për ujë shkova,  
dhe si padashje, flutrën për peshkim e hodha,  
duket, dita ishte e mbarë sepse tre herë provova,  
dhe si rrallë herë, tre trofta t'mira prej ujit nxora.  
Ka q e pat, dhe pasioni djaloshtar i të riut peshkatar,  
Mendjen nuk e lejoi me arsye tue drejtë e mbarë;  
Pa hanger buk si nises për rrugë të udhëtar?  
Peshkimi vazhdoi pa prânë kahun e rrjedhjes ujit,  
Prej Bregut të Lumit n'drejtimit të Portës së Shalës.  
Mbas peshkova deri te shkëmbi mbas urës s'Lotajt,  
Ku troftat e peshkuese ishin të panumërueme...  
U ula me pushue nën hijen e një peme gjigande...  
Përballë meje, uji kristal alpin i rotullohej shkambit,  
përrreth, sipër naltësive, gjelbërim i harlisun pakufi,  
nalt, si kapak i një kusije, qielli me diellin flakë nxehtësi.  
Heshtje hyjnore, çudie dhe gjinkallat nuk bzajshin!  
Lëvizja, një zhurm si pirajkë që teshat rreh për lamje,  
m'befasoi, për vetëmbrojtje solla trupin me shpejtësi,  
një bullarë uji i zi para meje kërcëu dhe n'ujë u hodh.  
Fajtori ishte unë, gjumin e zhegut ja prisha bullarit,  
Që kishte nevojë për nxehtësi mbas peshkimit të tij,  
Nëpër ujnat transparente të lumit me akull ftofësi.  
Thuprat e holla t'mrinave ku peshkun e kishevarë,  
filluen me m'peshue fort e duert me mi ba varrë.  
Megjithatë, i pangopur në peshkimin e pa pamë,  
Vazhdova gjuetinë pa mendue për kthimin n'kamë,  
derisa një grykë e naltë shkëmbore lëvizjen ma pengoi.  
Koha kishte kalue sipakujtue, dielli ishte tue prendue.  
Nisa rrugën e kthimit, i lodhun, por i lumtur prej peshkimit.  
Kur mbrrita te shkëmbi ku n'mesditë, bukur kishe pushue,



pamja m'u duk ndryshe sepse ndriçimi kishte ndryshue.  
Muzgu i mbramjes n'kontrast me reflekset e dritës qiellore  
Krijonte mjedis magjepës në ujnat e tejdukshme lumore.  
Mendova, ndoshta refleksi i argjentë i flutrës peshkimit  
terheqë ma tepër vemendjen e ndonji trofte kryemadhe,  
nuk i dihet, sot asht dita e rrallë... gjithçka mund të dalë!  
Sapo hodha flutrën në thellsinë e ujit tashma ngjyre gri,  
zhurma e ramjes së një guri të madh mbas shpinës u ndi,  
dhe filli i peshkimit në duert e mija u ngatërrue përcudi!  
Mendova se dikush, ndoj shok, po don me luejtë me mue,  
e për me m'frigue e mbrapa me qeshë, me gurë m'ka gjue.  
Pra "lojës" po i rridhe kënaqësinë e talljes s'po ja jap atij.  
Hodha përherën e dyti flutrën e peshkimit, por një zhurmë  
shumë ma e madhe dhe krejtë afër meje më futi frigën,  
solla kryet me shpejtësi me muejt me dallue gurin ogurzi  
por asgja nuk pashë, as dallova gurin e as hedhsin e tij.  
Ndiva mornica në krye, flokët mu duk se përpjetë u çuen.  
Gjithnji mbas shpine zhurmat e gurëve qe bijshin u ndijshin.  
Nuk mbrrita me kuptue e as me pa se prej kah ata vijshin.  
Rrugës në kthim me peshk përdore, ndodhinë emendova,  
por nuk gejshe asnjë logjikë argumentimi për çka provova.  
Ngjarja nuk mu shkëput për asnjë moment mendimit tim,  
E kuptojshe, se ishte e vështirë me arritë n'përfundim!  
Jeta asht mister, Bota asht mister, Universi asht mister...?!  
E vetmja absolute rreth nesh, asht se dogja asht relative!  
Me dyshim një mendim; ndoshta ngjarja ishte paralajmërim?  
Prej kuj, prej kah dhe pse?! Kuj ja prisha? Kecënova?  
Ku gabova dhe ç'ka gabova, unë tanë ditën vetëm peshkova!  
Por, misteri universal udhëzon, se në jetën që na rrethon  
Mund t'merren në konsideratë edhe ngjarje që nuk i beson!  
Dhe se si, as unë se di, por m'erdhi, një vegim n'mendit e mi:  
"Ai Nalt, shumë Nalt, Nanën Natyrë paska caktue kujdestare,  
me ruejtjé ekuilibrin mjedisor të jetës së qënieve planetare.  
Ndoshta atë ditë, pangishmënia n'peshkim e peshkimi pakufi,  
Nanën Natyrë fort e ka shqetësue, fort i paska dhanë idhnim"  
Unë paskam prishë ekuilibrin jetësor të qënieve t'gjalla n'liri,  
me habitat luginën e lumit të Shalës të maleve t'Dukagjinit!  
Dhe Shtojzovallet, Zanat rojtare besnike tëmaleve kreshnike,  
Gur hodhën kundër meje për ndalimin e gjuetisë jo etike!  
Faleminders Zanave dhe Shtojzovalleve, kuptova parimin moral  
"Me qenë i pangishëm në jetën shoqnore asht gabim fatal "

Pra, me rastin e themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" e njoha më nga afër dhe më mirë Ahmetin, të cilit që në takimin e parë me te, i thamë Profesor Ahmeti dhe kështu vijojmë ti themi dhe sot.

Profesori, në vijimësi na ka dhënë zemër dhe asnjëherë nuk na ndaloj e të na thotë ndonjë mangësi në punën tonë dhe pse kemi bërë dhe gabime, sigurisht pa dashje, por, ai në vijimësi më thoshte dhe më thotë: "Ju lumtë, që nuk po pushoni asnjëherë dhe që po punoni me metodën e vertikales, nga lart poshtë dhe jo me metodën e horizontales!"

Në vitin 2005, me rastin e vitit të tretë të daljes së gazetës "Dukagjini", kryesia e shoqatës i dha titullin e nderit "Anëtar

Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", së bashku me mjeshtrin e letrave shqipe, Fadil Kraja.

Kënaqësi të rrih me profesorin, se asnjëherë nuk u gjet pa letër e lapës në dore, nëpërmjet të cilave bën përpjekje të thotë e të shpjegojë atë që mendon, dhe me të thënë, se tre gjera janë më të rëndësishmet e njeriut intelektual!

Ai vijon dhe këto janë:

E para, letra, në të cilën shkruhet dhe kur shkruhet nuk humbet më, nuk i mbetet gojëdhënave;

E dyta, lapsi, me të cilin shkruhet në letër;

E treta, libri, nëpërmjet të cilit mëson.

Profesori asnjëherë nuk na tha, pse keni shkruar kështu apo ashtu, qoftë në gazetë

apo në librat që kemi botuar, por gjithnjë na ka thënë dhe na thotë, e rëndësishme është të shkruani, se koha ka për ti vlerësuar e ka për të përcaktuar se sa drejte e kemi pasur, se sa ajo që keni shkruar do i shërbejë së ardhmes.

Me rastin e dhënies së titullit "Qytetar Nderi i Bashkisë së Malësisë së Madhe" isha në ceremoninë e zhvilluar, u emocionova shumë, nga vlerësimet që u thanë për këtë burrë të Malësisë dhe e ndjeva veten më krenar, si person po se po, por edhe me tepër si kryetar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", që këtë burrë e kemi Anëtar Nderi të Shoqatës!

Të paçim profesor Ahmeti e ma gëzofsh datëlindjen!

Të uroj, në emër të shoqatës, që të

plotësosh 101 pranvera, me plot shëndet dhe me plot vitalitet si deri më sot!

Profesor, në qoftë se nuk të dalin 101 pranverat, besoj se këtu do të jemi dhe atëherë të shtojmë edhe të tjera...

Profesor Ahmeti, në këtë kuadër, me rastin e 80 vjetorit të lindjes suaj, më lejoni t'iu dhuroj një kopje të librit "Historiku i familjes Sanaj" ...

Profesor Zef Gjeta përgëzime për librin, për punën që keni bërë, për përkushtimin tuaj, në këtë 80 vjetor të lindjes së profesor Ahmeti!

Ju faleminderit!

Ndue Sanaj,  
13 korrik 2019

## REDAKSIA

Kryeredaktore: Suela Ndoja

Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.

Mundësoi Botimin:  
KOLË ÇARDAKU DHE PAL SHKAMBI